



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de



FLET PËR "EPOKËN E RE", GJENERALLEJTËNANT
RRAHMAN RAMA

FAQE 4-5

Kosova duhet ta ketë forcën e vet të armatosur

- Jemi në fund të procesit kur
Kosova duhet t'i ketë Forcat e
Armatosura. Mendoj se shumë
shpejt do ta realizojmë këtë ëndërr

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneraljtënant Rrahman Rama, ka bërë me dije se qëndrimi i çdo zyrtari të huaj që viziton Prishtinën është që Kosova duhet t'i ketë Forcat e Armatosura si çdo shtet tjetër. Në këtë intervistë

dhënë për gazetën "Epoka e re", ai është shprehur i bindur se transformimi i FSK-së do të ndodhë shumë shpejt. Se si do të arrihet deri te ky qëllim, Rama ka thënë se kjo është në duart e politikës. Ai ka deklaruar se FSK-ja është gati për transformim dhe po pret

vendimin politik. "Si komandant i FSK-së mund të them se në aspektin profesional ne jemi gati", ka thënë Rama. Ai i ka ftuar edhe deputetët e komunitetit serb të shkojnë tek elektorati i tyre dhe të shohin se sa ka punuar FSK-ja për ta

Kosova pret që BE-ja ta përshpejtojë liberalizimin e vizave

Një ditë pasi Komisioni Evropian ka publikuar raportin për Kosovën dhe pakon e zgjerimit, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës,

Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Behgjet Pacolli, kanë shprehur përkushtimin e tyre për t'u bërë pjesë e familjes evropiane, por ata

presin nga Bashkimi Evropian ta përshpejtojë procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës

FAQE 3



Fakulteti i Mjekësisë rrezikon të mbyllet



Fakulteti i Mjekësisë dhe disa klinika në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në vitin 2021 rrezikohen të mbyllen për shkak të mungesës së stafit akademik në Fakultetin e Mjekësisë. Kështu ka

deklaruar koordinatori për zhvillim akademik dhe cilësi, Fisnik Kurshumliu, në tryezën me temë "Krizë e klinikave të QKUK-së si pasojë e mungesës së profesorëve në Fakultetin e Mjekësisë"

FAQE 6

RENOVA
PUTZ

Magdioni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë

Product of EPS and XPS

Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI

www.kolegjobiznesi.com
info@kolegjobiznesi.com

038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO

Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

AKTUALE

**KURTI: PROBLEM PËR
KOSOVËN ËSHTË PAPUNËSIA
DHE NDARJA E QYTETIT TË
MITROVICËS**

F. 3

**MBIKËQYRJA
PARLAMENTARE FUQIZON
INTEGRITETIN E POLICISË
SË KOSOVËS**

F. 7

**MAXHUNI KËRKON
PËRKRAHJEN E KFOR-IT PËR
ANËTARËSIMIN NË INTERPOL**

F. 7

EKONOMI

**MINISTRI HASANI FTON
BIZNESET E HUAJA TË
INVESTOJNË NË KOSOVË**

F. 8

**KOSOVA E GATSHME PËR
NISMAT RAJONALE NË
FUSHËN E DIGJITALIZIMIT**

F. 9

KULTURË

**SHËNOHET DITA
NDËRKOMBËTARE E
MONUMENTEVE DHE
LOKALITETEVE**

F. 13

SPORT

**TRAJNERI NGA KOSOVA KA
SYNIME TË MËDHA ME ATSV
ERLANGEN**

F. 18

**VËLLAZNIMI - PRISHTINA,
FINALJA E KUPËS NË FUTBOLL**

F. 18

Tusku viziton Kosovën javën e ardhshme

BRUKSEL, 18 PRILL - Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, do ta vizitojë në javën e ardhshme rajonin e Ballkanit Perëndimor. Vizita e tij do të nisë në Shqipëri më 24 prill, nga ku do të vazhdojë në Mal

të Zi, Serbi, Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë dhe Maqedoni. Duke folur në Parlamentin Evropian në Strasburg, Tusk tha se do t'i përçojë mesazhin rajonit se BE-ja do të vazhdojë të jetë partnerja më e

besueshme dhe investitorja më e madhe. "Samiti për Ballkanin Perëndimor në Sofje duhet ta konfirmojë perspektivën evropiane të rajonit dhe, çfarë është më e rëndësishme, duhet t'i përmirësojë lidhjet

me rajonin dhe brenda tij", tha Tusk. Samiti në Sofje, i paralajmëruar të mbahet më 17 maj, do të jetë takimi i parë i nivelit të lartë midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor pas 15 vjetësh.



Mogherini në Shqipëri: Punoni së bashku për të ecur tutje drejt BE-së

Shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, tha në Tiranë se rekomandimi pozitiv i Komisionit Evropian për hapjen e negociatave me Shqipërinë ishte rezultat i një pune kolektive të shqiptarëve, por edhe ecuria e mëtejshme është një përgjegjësi e përgjithshme

TIKANË, 18 PRILL - Shefja e Politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, ka qëndruar të mërkurën për vizitë në Shqipëri, me ç'rast ua ka dorëzuar krerëve të shtetit Raportin e Progresit, i cili parasheh hapjen e negociatave për anëtarësim.

Konferencën për medie Mogherini e ka filluar në gjuhën shqipe duke i uruar për këtë sukses liderët shtetërorë. Por, ajo ka kërkuar nga pozita dhe opozita të punojnë së bashku për t'i përbushur obligimet që kanë para vetes. "Urime! Ishte shumë e rëndësishme që ta them këtë në gjuhën shqipe që shqiptarët ta kuptojnë shumë mirë. Ky është momenti për ta njohur rezultatit e arritur nga të gjithë bashkë në Shqipëri dhe angazhimi për të punuar së bashku, qeveria me opozitën. Përpjekjet kolektive nuk janë vetëm institucionet, por

edhe njerëzit. Të gjithë së bashku ta vazhdojmë këtë punë që do të jetë edhe më e madhe kur të nisim negociatat", ka deklaruar Mogherini gjatë konferencës së përbashkët me kryeministrin Edi Rama.

Ajo ka treguar se pesë prioritetet kyçe do të vazhdojnë të jenë baza e punës së përbashkët. "Procesi i zgjerimit gjithmonë mbështetet në meritë dhe do ta përsëritim gjithmonë. Vitin e kaluar ishim krah për krah njëri-tjetrit ku unë përballë medieve u shpreha mjaft qartësisht përballë qytetarëve të Shqipërisë se Komisioni Evropian do të kishte dhënë rekomandim pozitiv për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE për Shqipërinë kur zbatimi i reformës në drejtësi, posaçërisht vettingu të fillonte. Ju e realizuat dhe ne e përbushëm atë që thamë", është shprehur Mogherini. Ajo tha se Shqipëria



është vendi i dytë me popullsinë më të re të Evropës dhe vendi me besueshmërinë më të lartë ndaj BE-së.

Shefja e diplomacisë evropiane ka theksuar se vlerësimi i Komisionit tregon qartësisht se Shqipëria ka përbushur kushtet që ishin vendosur në raportin dhe rekomandimet e fundit të miratuar një vit e gjysmë më parë dhe Shqipëria është e gatshme për t'i hapur negociatat. "Nuk është vetëm një vendos-

mëri e fortë e popullit shqiptar për t'u bashkuar me BE-në, por në interes të BE-së që ta marrë Shqipërinë në BE kur ajo të jetë gati për këtë dhe shpresoj se do të jetë shpejt. Pesë përparësitë kryesore do të mbeten elementet kyçe mbi të cilat qytetarët shqiptarë do të mbeten baza për punën tonë të përbashkët", ka deklaruar Mogherini.

Ndërsa kryeministri Edi Rama tha se rekomandimi për hapjen e negociatave ishte një rezultat i

shumëpritur, dhe Shqipëria ka marrë atë që meriton, as më shumë e as më pak. Ai theksoi se pastrimi i policisë dhe drejtësisë do të vazhdojë me ritme të larta. "Ne i kemi bërë të gjitha detyrat e shtëpisë që na u kërkuar. Tani kemi në dorë diplomën e një provimi shumë të vështirë të kaluar me sukses dhe me këtë diplomë ne do t'u drejtohem të gjithë vendeve anëtare për ta kërkuar hapjen e negociatave", tha Rama.

Haradinaj, drekë pune me Hahnin



Shkup, 18 prill - Në kuadër të Samitit Digjital të Ballkanit Perëndimor që është mbajtur në Shkup të Maqedonisë, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të mërkurën një drekë pune me komisionarin e BE-së për zgjerim, Johannes Hahn.

Në këtë drekë pune kanë qenë

edhe kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, kryesuesi i Këshillit të Ministrave të Bosnjë e Hercegovinës, Denis Zvizdiq, zëvendëskryeministrja e Shqipërisë, Senida Mesi, ministrja e Ekonomisë e Malit të Zi, Dragica Sekulij dhe komisarja evropiane për ekonominë digjitale dhe shoqëri, Mariya Ivanova Gabriel.

Forcimi i bashkëpunimit ekonomik rajonal dhe rruga evropiane e vendeve të Ballkanit Perëndimor, ishin temat që u diskutuan në këtë drekë pune. Në këtë takim është theksuar se digjitalizimi i shteteve të Ballkanit Perëndimor është parakusht elementar për integrimin në Bashkimin Evropian.

Gjikhuri: Rruga e Arbrit nis brenda muajit

TIKANË, 18 PRILL - Qeveria synon të përfundojë brenda këtij mandati të gjitha akset kombëtare rrugore. Ambicia u njoftua nga ministri i Infrastrukturas, Damian Gjikhuri, gjatë raportimit të punës për këtë gjashtëmuor para grupit parlamentar socialist.

Gjikhuri tha se aksi Qukës-Qafë-Ploçk kërkon 50 milionë dollarë të

tjera dhe fajësoi për këtë projektin e dobët, ndërsa premtoi përfundimin edhe të pjesës së Rrugës së Kombit, Kukës-Morinë, që tha se do të kërkojë 11 milionë euro për këtë vit. "Janë projekte jo të mira, me ura që kanë disnivele. Edhe në Kukës-Morinë u nis me rrugët dhe u lanë për në fund urat. Do ta përfundojmë atë segment

me 11 milionë euro. Këto janë kosto të projekteve të menaxhuara keq të së kaluar", deklaroi ai.

Një tjetër aks problematik, afatet për përfundimin e të cilit janë vetë pa afate, është rruga Tiranë-Elbasan. Gjikhuri premtoi përbjlljen e këtij aksi brenda këtij viti, por që do të kërkojë 14 milionë

dollarë shtesë. "Të martën kemi marrë konfirmim për financimin shtesë për pjesën e mbetur të rrugës Tiranë-Elbasan. Pra, janë 14 milionë dollarë të tjera që do të hidhen për ta përfunduar segmentin nga zona e Ibës në Tunelin e Elbasanit. Brenda këtij viti edhe ai aks përfundon plotësisht", tha Gjikhuri.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

- Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
- ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

Kosova pret që BE-ja ta përshpejtojë liberalizimin e vizave

Një ditë pasi Komisioni Evropian ka publikuar raportin për Kosovën dhe pakon e zgjerimit, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Behgjet Pacolli, kanë shprehur përkushtimin e tyre për t'u bërë pjesë e familjes evropiane, por ata presin nga Bashkimi Evropian ta përshpejtojë procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës

**EPOKA
ERE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 18 PRILL - Përfaqësuesit e institucioneve të vendit dhe njohës të proceseve integruese kanë komentuar Raportin më të ri të Progresit të publikuar nga Komisioni Evropian si pjesë e paketës vjetore të zgjerimit, ku janë prezantuar përparimet dhe ngeçjet e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se Bashkimi Evropian i vlerësoi më në fund të arriturat e Kosovës sa i përket përmbushjes së kriterëve për liberalizimin e vizave. Ai ka theksuar se në këtë fazë nuk ka asgjë më të rëndësishme në agjendën evropiane për Kosovën sesa udhëtimi i qytetarëve tanë në Zonën Shengen, i cili do të krijojë mundësi më të mëdha për transformimin e politikës, të shoqërisë dhe ekonomisë. "Dekada e Re ka kuptim vetëm pa viza në Evropë dhe zbatimi i MSA-së dhe ERA-së do të hyjnë në një dinamikë të re kur nuk do të ketë barriera të pakuptimit të lëvizjes së lirë. Institucionet e Kosovës do t'i adresojnë edhe sfidat dhe kritikën që janë identifikuar në raportin e BE-së pasi vetëm kështu forcojmë dhe ndërtojmë të ardhmen evropiane për qytetarët tanë", ka thënë Veseli.

Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka theksuar se mirëpret Raportin për vendin të Komisionit Evropian duke e konsideruar real dhe objektiv. Ajo ka theksuar se është shumë e rëndësishme që Komisioni Evropian vlerëson se Kosova ka bërë progres në shumë fusha. "Raporti në përgjithësi ka vlerë-

suar se institucionet e Kosovës kanë arritur progres në fushën e kriterëve ekonomike, normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë si dhe në përgjithësi sa i përket harmonizimit të legjislacionit me standardet e BE-së", është shprehur ministrja Hoxha, duke shtuar se raporti është udhërrëfyes dhe orientim për institucionet tona për ta shtuar punën në fushat e caktuara. "Njohja e këtij progresi është shumë e rëndësishme për procesin e liberalizimit të vizave", ka thënë Hoxha.

Ajo ka thënë se gjatë këtij viti institucionet e vendit duhet të fokusohen më shumë në fuqizimin e zbatimit të ligjeve, implementimin e reformës së administratës publike, ta vazhdojnë luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar si dhe ta rrisin konfiskimin e aseteve. "Po ashtu, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet fushës së arsimit dhe punësimit si dy fusha kyçe për implementimin e suksesshëm të MSA-së. Si ministre e Integritimit Evropian do të angazhohem maksimalisht që të gjitha institucionet ta shtojnë punën për t'i adresuar sfidat e evidentuara në raportin për vendin", është shprehur Hoxha. Zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka thënë se publikimi i pakos së zgjerimit nga Komisioni Evropian të martën në Strasburg paraqet lajm të mirë për gjithë Ballkanin Perëndimor. Pacolli ka thënë se dhënia e rekomandimit për hapjen e negociatave për Shqipërinë e Maqedoninë rritë shpresat që të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë të ardhme të garantuar në familjen evropiane.



Ministri Pacolli ka thënë se Kosova mirëpret vlerësimet e Komisionit Evropian, në veçanti vëmendjen e dhënë përshpejtimin të reformave që janë pjesë e Agjendës Evropiane të Reformave në muajt e fundit. "Gjithashtu, është lajm i mirë që Komisioni Evropian ka përshëndetur përpjekjet e pareshtura të institucioneve tona për përmbushjen e kriterëve për liberalizim të vizave. Duke pasur parasysh se qytetarët tanë mbesin të vetmit në Evropë pa lëvizje të lirë, ne presim që institucionet e Bashkimit Evropian do t'i përshpejtojnë përpjekjet e tyre për të garantuar lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës. Kjo tani nuk është më një privilegj, por një e drejtë e

munguar për qytetarët tanë", ka thënë Pacolli, duke shtuar se Kosova do t'i zbatojë reformat që dalin nga agjenda evropiane. "Në rolin tim të zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Jashtëm mund t'i siguroj qytetarët e Kosovës dhe partnerët evropianë që ne do të kemi një fokus edhe më të shtuar në implementimin e reformave që dalin nga agjenda jonë evropiane. Në këtë mënyrë ne do të sigurojmë një progres më të shpejtë në rrugën tonë evropiane", ka thënë Pacolli.

Nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, zyrtarët e lartë të BE-së thanë se Serbia dhe Mali i Zi kanë bërë disa përparime dhe po vazhdojnë negociatat në procesin e përafritimit me BE-në, ndërko-

që është lansuar hapja e negociatave edhe me Shqipërinë dhe Maqedoninë, kurse Kosova dhe Bosnja e Hercegovina janë në rrugën e përmbushjes së kriterëve evropiane para se të mund të llogarisin në negociatat e anëtarësimit.

Reformat në sundimin e ligjit, ekonomia e lirë e tregut, respektimi i lirisë njerëzore deri te harmonizimi i legjislacionit me atë të BE-së, mbeten parakushtet që vendet ballkanike duhet t'i plotësojnë në rrugën e tyre integruese.

Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, tha se me strategjinë e re të BE-së për Ballkanin Perëndimor është rikonfirmuar e ardhmja evropiane e këtij rajoni.

Reka: Nuk ka anëtarësim në BE pa zgjidhjen e kontesteve fqinjësore

Ish-ambasadori i Maqedonisë në Bruksel, njëherësh profesor i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka thënë se Raportit të Progresit të Komisionit Evropian iu gëzuan vetëm Shqipëria dhe Maqedonia. Ndërsa, sipas tij, u zbeh ngazëllimi fillestar për Malin e Zi dhe Serbinë. "Kurse Bosnja e Hercegovina dhe

Kosova morën vlerësimet më të dobëta", ka thënë Reka. Ai ka shtuar se mesazhi i përbashkët ishte: anëtarësimi nuk është i garantuar, por i merituar. "Edhe pse Brukseli nuk do që Ballkani-jashtë BE-së të rrëshqas në zonë të vakuimit të sigurisë; anëtarësim nuk ka pa zgjidhjen e kontesteve fqinjësore, as pa dekriminalizimin e rajonit", ka

deklaruar Reka. Ai ka theksuar se vlerësimi për "shtetin e kapur" nuk u fshi as nga raportet e sivjetme. "Ballkani do të vazhdojë të mbetet hapësirë gjeografike, por jo edhe politike evropiane. Fundja, këto raporte janë teknike. Vendimi politik pritet në Samitin e Këshillit Evropian në qershor", ka thënë Reka.

Kurti: Problem për Kosovën është papunësia dhe ndarja e qytetit të Mitrovicës



PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe sekretari për marrëdhënie me jashtë, Boiken Abazi, kanë pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Norvegjisë, Per Strand Sjaastad, me të cilin kanë diskutuar për zhvillimet e fundit politike, përfshirë edhe Raportin e Progresit. Kurti ka shpjeguar se dy problemet kryesore për Kosovën janë

papunësia enorme dhe ndarja e qytetit të Mitrovicës. Sipas tij, problemi i parë lidhet me korrupsionin dhe modelin e gabuar ekonomik që është zbatuar në Kosovë, ndërsa i dyti lidhet me ndërhyrjen që Serbia vazhdon të bëjë në Kosovë përmes strukturave të kontrolluara dhe financuara prej saj.

Kurti ka shpjeguar hapat e propozuar nga Lëvizja

Vetëvendosje në lidhje me vlerësimin e brendshëm të dialogut të deritanishëm me Serbinë si dhe për nevojën e një dialogu të brendshëm e demokratik, të hapur dhe transparent, mes aktorëve politikë dhe shoqërisë civile në Kosovë për të arritur një konsensus lidhur me kërkesat e kushtet, synimet e kornizat e dialogut në të ardhmen.

Flet për "Epokën e re", gjeneralletenant Rrahman Rama

Kosova duhet ta ketë fo

- Jemi në fund të procesit kur Kosova duhet t'i ketë Forcat e Armatosura. Mendoj se shumë shpejt do ta realizojmë këtë ëndërr

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, ka bërë me dije se qëndrimi i çdo zyrtari të huaj që viziton Prishtinën është që Kosova duhet t'i ketë Forcat e Armatosura si çdo shtet tjetër. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai është shprehur i bindur se transformimi i FSK-së do të ndodhë shumë shpejt. Se si do të arrihet deri te ky qëllim, Rama ka thënë se kjo është në duart e politikës. Ai ka deklaruar se FSK-ja është gati për transformim dhe për këtë po pret vendimin politik. "Si komandant i FSK-së mund të them se në aspektin profesional ne jemi gati", ka thënë Rama. Ai i ka ftuar edhe deputetët e komunitetit serb të zbresin tek elektorati i tyre dhe të shohin se sa ka punuar FSK-ja për ta

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 18 PRILL - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, është shprehur i bindur se shumë shpejt kjo forcë do të transformohet në Forca të Armatosura të Kosovës. Ai ka thënë se i takon politikës ta gjejë mënyrën se si të arrihet deri te ky qëllim. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rama ka deklaruar se FSK-ja është në pritje të vendimit politik për të marrë përgjegjësi të reja, për të cilat është gati. "E kam thënë edhe më herët se FSK-ja i ka bërë të gjitha përgatitjet dhe është e gatshme të marrë përgjegjësi të reja. Kurdo që të merret vendimi politik për transformimin e FSK-së, ne jemi të gatshëm të fillojmë këtë proces dhe t'i implementojmë planet tona, planin afatmesëm

dhe planin afatgjatë", ka thënë Rama. Ai ia ka tërhequr vërejtjen e politikës që të mos vonohet shumë me këtë vendim, duke shtuar se ky proces duhet të bëhet në koordinim me partnerët strategjikë të FSK-së. "Nuk mund të them se nuk po vonohet. Këtë e dinë liderët tanë politikë por, siç dihet, janë disa procese të cilat kërkojnë një koordinim me të gjithë aktorët, qofshin ata të brendshëm apo edhe të jashtëm. Qëllimi ynë është të jemi pjesë e strukturave euroatlantike", është shprehur ai.

Gjeneralletenant Rrahman Rama ka ftuar edhe deputetët e komunitetit serb që të zbresin tek elektorati i tyre dhe të shohin se sa ka punuar FSK-ja për ta. "Është mirë që edhe politikanët të zbresin ndonjëherë tek komuniteti i tyre dhe ta shohin realitetin se çfarë është duke ndodhur me komunitetin e tyre, e mos të merren



vetëm me deklarata. Ne kemi punuar me komunitetet dhe ua kemi treguar ofertën e FSK-së, e cila nuk ka bërë asnjë dallim në mes të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Në bazë të këtij angazhimi, ne kemi arritur që tani në brendi të FSK-së t'i kemi të përfshira të gjitha minoritetet, nga secila pjesë e territorit të Kosovës", është shprehur Rama. Sipas tij, qëndrimi i çdo zyrtari të huaj që viziton Prishtinën është që Kosova duhet t'i ketë Forcat e Armatosura si çdo shtet tjetër. "Qëndrimi i çdo zyrtari të huaj

që vjen në Kosovë është që Kosova si çdo shtet tjetër duhet ta ketë forcën e vet të armatosur. Pra, Forcat e Armatosura duhet të krijohen. Se si do të gjenden format dhe metodat për arritjen e këtij qëllimi, është një çështje politike. Secili vend, qoftë anëtar i NATO-s ose joanëtar, është i vetëdijshëm se Kosova ka nevojë t'i ketë forcat e saj të armatosura sikurse çdo shtet tjetër", ka thënë Rama.

"Epoka e re": Z. Rama, pasi arritjes së kapaciteteve të kërkuara nga NATO-ja, me çfarë detyrash po merret FSK-ja?

Rama: FSK-ja ka një mandat dhe një mision në bazë të ligjit dhe Kushtetutës së Kosovës. Duke u bazuar në mandatin dhe misionin e saj, ne jemi duke i kryer detyrat ashtu siç i kemi të planifikuara në bazë të ligjit, Kushtetutës dhe rregullores që kemi. Gjatë kësaj periudhe i kemi kushtuar rëndësi të jashtëzakonshme ngritjes profesionale brenda FSK-së,

mbajtjes së kapaciteteve aktuale që kemi, duke filluar prej çminimit, kërkim-shpëtim, mbrojtjes kimike-biologjike, aktiviteteve xheniere, por edhe zhvillimit të njërive brendapërbrenda që i kemi në mbështetje të këtyre kapaciteteve. Po ashtu, jemi mirë edhe me pajisjet individuale dhe kolektive. Gjithashtu, qëndrojmë mirë edhe zhvillimin profesional të pjesëtarëve qoftë brenda institucionit nëpër kurset tona specialistike për fusha të caktuara, qoftë me përkrahjen e jashtëzakonshme të partnerëve tanë në kuptimin e ngritjes profesionale të FSK-së.

"Epoka e re": Paralajmërimet e liderëve politikë janë që shumë shpejt do të ndodhë transformimi i FSK-së në Forca të Armatosura. Kur pritni që kjo të ndodhë?

Rama: Si komandant i FSK-së mund të them se në aspektin profesional ne jemi gati. FSK-ja i ka kryer të gjitha obligimet që

FSK-ja i ka bërë të gjitha përgatitjet dhe është e gatshme të marrë përgjegjësi të reja. Kurdo që të merret vendimi politik për transformimin e FSK-së, ne jemi të gatshëm ta fillojmë këtë proces dhe t'i implementojmë planet tona, planin afatmesëm dhe planin afatgjatë.
Gjeneralletenant Rrahman Rama



rcën e vet të armatosur

euroatlantike, pjesë e NATO-s. Se kur do të ndodhë kjo, prapë varet prej vendimit politik. Me rëndësi është se ne jemi në rrugën e duhur. U them me përgjegjësinë më të lartë se jemi institucioni më i respektueshëm në vend. Ky respekt nga ana e të gjithë qytetarëve të Kosovës është falë angazhimit dhe përkushtimit të pjesëtarëve të FSK-së, të oficerëve dhe nënoficerëve. Ne jemi të gatshëm në çdo kohë që t'i përkrahim institucionet tona dhe qytetarët duke u bazuar në mandatin tonë kushtetues.

"Epoka e re": Pra, FSK-ja tani është vetëm në pritje të vendimit politik për transformimin e saj?

Rama: E kam thënë edhe më herët, FSK-ja i ka bërë të gjitha përgatitjet dhe është e gatshme të marrë përgjegjësi të reja. Kurdo që të merret vendimi politik për transformimin e FSK-së, ne jemi të gatshëm ta fillojmë këtë proces dhe t'i implementojmë planet tona, planin afatmesëm dhe planin

Këtë vit jemi pjesë e 11 ushtrimeve fushore që do të ndodhin në rajon dhe më gjerë. Ajo që është më e rëndësishmja, në fillim të muajit maj në Kosovë do ta kemi ushtrimin 'Shqiponja 6'. Pra, është hera e parë që ky ushtrim nuk do të jetë nacional, por internacional.

**Gjenerallejtënant
Rrahman Rama**

kanë ndalë nga rishikimi i sektorit të sigurisë në vitin 2014. Pra, prej asaj kohe ne i kemi kushtuar rëndësi mbajtjes së kapaciteteve aktuale që janë të deklaruara nga ana e NATO-s, zhvillimin e tyre, pajisjet dhe profesionalizimin e tyre. Në të njëjtën kohë, ne i kemi bërë të gjitha parapërgatitjet që, kurdo që të merret vendimi politik, FSK-ja i ka planet e detajuara. Pra, nga ai moment ne do të fillojmë implementimin e këtyre planeve të cilat i kemi hartuar me partnerët tanë strategjikë. Është me rëndësi të bëhet me dije se prej fillimit çdo gjë që kemi ndërtuar e kemi bërë duke u bazuar në standardet e NATO-s. Po ashtu, brenda FSK-së kemi një ekip këshillues të NATO-s, nga i cili çdo ditë kemi këshillime dhe koordinime të përbashkëta. Pra, çdo që kemi bërë deri më tash e kemi bërë mbi bazën e standardeve të NATO-s. Qëllimi kryesor yni ka qenë dhe është të jemi pjesë e strukturave

afatgjatë. Në përpilimin e këtyre planeve kemi qenë të kujdesshëm të mos kemi ngarkesa të mëdha, qoftë edhe financiare, duke marrë për bazë gjendjen ekonomike të vendit. Oficerët dhe nënoficerët në çdo trajnim apo operacion që kanë marrë pjesë jashtë vendit, kanë dalë si studentët më të suksesshmit. Kjo neve natyrisht se na ka bërë krenarë, sepse ka treguar disiplinën dhe përkushtimin që kanë ata për uniformën dhe për vendin.

"Epoka e re": A po vonohet politika për marrjen e këtij vendimi, meqenëse FSK-ja i ka përmbushur kriteret e kërkuara që disa vjet dhe është e gatshme për transformim?

Rama: Nuk mund të them se nuk po vonohet. Këtë e dinë liderët tanë politikë por, siç dihet, janë disa procese që kërkojnë koordinim me të gjithë aktorët, qofshin ata të brendshëm apo të jashtëm. Qëllimi ynë është të jemi pjesë e strukturave euroatlantike. Me këto kapacitete që kemi, jemi në diskutim me shumë vende dhe ua kemi bërë ofertat që me këto kapacitete mund të shërbejmë edhe në misionet paqeruajtëse në të gjithë botën. Në këtë drejtim mendoj se jemi në rrugë të mirë që, një ditë, qoftë edhe me një numër simbolik të pjesëtarëve, të jemi pjesë e këtyre misioneve paqeruajtëse në vendet ku ka kriza.

"Epoka e re": Pengesë kryesore për transferimin e FSK-së janë deputetët e minoritetit serb, ndonëse kjo forcë në gjirin e vet

ka edhe shumë pjesëtarë të këtij komuniteti. Si komandant i kësaj force, cili është mesazhi juaj për këta deputetë?

Rama: Në kuptimin profesional ne kemi arritur progres të jashtëzakonshëm. Është konstatim i përgjithshëm se FSK-ja është një forcë kredibile dhe gjithëpërfshirëse. Kur themi gjithëpërfshirëse, i bie se kemi më tepër se 11 për qind të pjesëtarëve të FSK-së nga minoritetet. Edhe këtë vit i kemi kushtuar rëndësi rekrutimit të pjesëtarëve nga minoriteti serb, ku kemi arritur që mbi pesë për qind të pjesëtarëve që shërbejnë në FSK të jenë nga minoriteti serb. Kështu që, është mirë që edhe politikanët të zbresin ndonjëherë tek komuniteti i tyre dhe ta shohin realitetin se çfarë është duke ndodhur me komunitetin e tyre dhe mos të merren vetëm me deklaratat. Ne kemi punuar me komunitetet dhe ua kemi treguar ofertën e FSK-së, e cila nuk ka bërë asnjë dallim në mes të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Në bazë të këtij angazhimi kemi arritur që tani në brendi të FSK-së t'i kemi të përfshira të gjitha minoritetet nga secila pjesë e territorit të Kosovës.

"Epoka e re": Pothuajse çdo javë keni vizita të ndryshme të zyrtarëve të NATO-s, por edhe të zyrtarëve të vendeve anëtare të NATO-s. Cili është qëndrimi i tyre për përgatitjen profesionale të FSK-së dhe për transformimin e kësaj force?

Rama: Së fundi kemi pasur edhe vizitën e zëvendëssekre-

tarit të NATO-s dhe mesazhi i tij ka qenë se FSK-ja është një forcë profesionale, shumetnike dhe është në shërbim të gjithë qytetarëve. Pra, me punën që ka bërë deri më tani kjo forcë, ka arritur një respekt i jashtëzakonshëm te partnerët e saj strategjikë. Kemi çdo lëvdatë prej tyre. Mirëpo duhet ta kuptojmë edhe një çështje, se ky proces nuk është i lehtë, sepse kemi pesë vende anëtare të NATO-s të cilat nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës. Por, gradualisht, me punën tonë, mund t'i bindim ato vende. Përveç vizitave dhe kontakteve të vazhdueshme që kemi me partnerët tanë, FSK-ja merr pjesë edhe në shumë ushtrime të përbashkëta, qofshin ato rajonale apo globale. Vlen të theksohet se këtë vit jemi pjesë e 11 ushtrimeve fushore që do të ndodhin në rajon dhe më gjerë. Ajo që është më e rëndësishmja, në fillim të muajit maj në Kosovë do ta kemi ushtrimin 'Shqiponja 6'. Pra, është hera e parë që ky ushtrim nuk do të jetë nacional, por internacional. Pjesëmarrëse në këtë ushtrim do të jenë 12 shtete me trupat e tyre ushtarake. Natyrisht se për këtë ushtrim i kemi bërë të gjitha parapërgatitjet me partnerët tanë, ndërsa tani e presim zbatimin e këtij ushtrimi.

"Epoka e re": Në të gjitha takimet me partnerët e FSK-së, kërkesë permanente e juaja është që FSK-ja të jetë ofruesja e sigurisë përmes operacioneve të mbështetjes së paqes. Çfarë përgjigje merrni prej partnerëve në këtë çështje?

Rama: Qëndrim i çdo zyrtari të huaj që vjen në Kosovë është se Kosova, si çdo shtet tjetër, duhet ta ketë forcën e vet të armatosur. Pra, Forcat e Armatosura duhet të krijohen. Se si do të gjinden format dhe metodat për arritjen e këtij qëllimi, kjo është një çështje politike. Por, secili vend, qoftë anëtar i NATO-s ose joanëtar, është i vetëdijshëm se Kosova ka nevojë t'i ketë forcat e saj të armatosura sikurse çdo shtet tjetër. Nëse shihet struktura e FSK-së, planet, pajisjet kolektive dhe individuale, është e qartë se Kosova po ndërton një forcë që është në shërbim të qytetarëve dhe që krijon siguri për qytetarët e saj. Kështu që, tani jemi në fund të procesit kur Kosova duhet t'i ketë Forcat e Armatosura dhe mendoj se shumë shpejt do ta realizojmë këtë ëndërr tonën.



Fakulteti i Mjekësisë rrezikon të mbyllet

Fakulteti i Mjekësisë dhe disa klinika në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në vitin 2021 rrezikohen të mbyllen për shkak të mungesës së stafit akademik në Fakultetin e Mjekësisë. Kështu ka deklaruar koordinatori për zhvillim akademik dhe cilësi, Fisnik Kurshumliu, në tryezën me temë "Kriza e klinikave të QKUK-së si pasojë e mungesës së profesorëve në Fakultetin e Mjekësisë"

EPOKA E RE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 18 PRILL - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të mërkurën në tryezën me temë "Kriza e klinikave të QKUK-së si pasojë e mungesës së profesorëve në Fakultetin e Mjekësisë", në të

cilën është diskutuar për mungesën e kuadrove në klinikat e QKUK-së ku, sipas të dhënave të prezantuara, del se gjendje jo e mirë është në Klinikën e Kirurgjisë, të Internos, të Pediatrisë dhe të Gjinekologjisë. Në këtë tryezë, përveç ministrit Bytyqi, të pranishëm ishin edhe ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili dhe këshilltari i kryemi-

nistrin, Luan Jaha, të cilët ofruan gatishmërinë për mbështetje për tejkalimin e situatës së krijuar në klinikat e lartpërmendura.


Ministri Bytyqi me këtë rast tha se, sipas informatave të prezantuara, situata është shqetësuese, sepse Fakulteti i Mjekësisë shkon përtej edukimit të shoqërisë, duke qenë se kemi të bëjmë me edukimin dhe shëndetin e njerëzve.

Ministri Bytyqi si mundësi për gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme e shtroi idenë e formimit të një grupi punues, i cili, pas grumbullimit të informacioneve, do të dilte me rekomandime të cilat do të çonin në angazhimin e institucioneve, Qeverisë dhe ministrive përkatëse. "Pjesëmarrja e përfaqësuesve të kryeministrit dhe ministrit të Shëndetësisë tregon

që si Qeveri jemi të gatshëm për të mbështetur dhe zgjidhur problemet. Jemi të gatshëm për bashkëpunim dhe mbështetje mirëpo, para se të vijmë te mbështetja finale, duhet të bëhen disa hapa të tjerë. Duhet ta dimë saktësisht cilat kanë qenë shkaqet që e kanë sjellë situatën deri këtu, në mënyrë që kur të japim propozime për zgjidhjen, të mos na përsëritet situata që ka qenë paraprakisht", është shprehur ministri Bytyqi.

Ministri Bytyqi ka theksuar se, nëse ka kuadro të mjaftueshme, por mungon riorganizimi, atëherë Ministria e Arsimit dhe Ministria e Shëndetësisë do ta mbështesin zgjidhjen e këtij problemi, i cili flet për një problem ku përfshihen dy institucione të rëndësishme: Fakulteti i Mjekësisë dhe QKUK-ja.

Koordinatori për zhvillim akademik dhe cilësi, Fisnik Kurshumliu, ka thënë se Fakulteti i Mjekësisë dhe disa klinika në QKUK në vitin 2021 rrezikohen të mbyllen për shkak të mungesës së stafit akademik. "Fakulteti i Mjekësisë është në gjendje kritike sa i përket stafit akademik krahasuar me vitet paraprake në raport me vendet e rajonit. Kjo gjendje ka implikime serioze në ekzistencën e klinikave të QKUK-së, në këtë mënyrë rrezikohet akreditimi i këtyre klinikave si institucione të mjekësisë terciare, rrjedhimisht pra rrezikohet edhe riakreditimi i Fakultetit të Mjekësisë në vitin 2021 meqë për t'u riakredituar duhet të ketë bashkëpunim me një institucion të mjekësisë terciare siç është QKUK-ja", ka thënë Kurshumliu.



Kryesuesi i KGJK-së, pjesëmarrës në organizatat simotra në Tiranë

TIRANË, 18 PRILL (ER) - Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Nehat Idrizi, po merr pjesë në takimin e Bordit Drejtues të Rrjetit Ballkanik dhe Euro-Mesdhetar të Këshillave Gjyqësorë, i cili po mbahet në Tiranë.

Takimi ishte i përqendruar në organizimin e përgatitjeve për konferencën plenare të BEMNCJ në vitin 2018; ndryshimet e mundshme statusore të rrjetit; ecurinë e reformave në vendet anëtare; rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar mes vendeve anëtare të rrjetit dhe me organizata partnere etj.

Përveç këtyre temave të lartcekura, anëtarët e Rrjetit me theks të veçantë diskutuan për domosdoshmërinë e sigurimit të pavarësisë së gjyqësorit nga çdo lloj ndërhyrje që cenon parimet kushtetuese dhe ndërkombëtare të së drejtës.

Gjithashtu, anëtarët e Rrjetit morën vendim që takimi plenar dhe konferenca e XIII e Rrjetit Ballkanik dhe Euro-Mesdhetar të Këshillave Gjyqësorë do të mbahet në Budvë, të Malit të Zi, më



21-22 qershor.

Rrjeti Ballkanik dhe Euro-Mesdhetar i Këshillave Gjyqësorë është një organizëm në përbërje të të cilit janë Këshillat Gjyqësorë të vendeve të Ballkanit dhe të Mesdheut Evropian: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria,

Hungaria, Italia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Turqia, Kosova dhe Serbia.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës u pranua si anëtar i Rrjetit Ballkanik dhe Euro-Mesdhetar të Këshillave Gjyqësorë më 28 maj 2015 dhe për herë të parë po merr pjesë në Bordin e këtij rrjeti.

EULEX-i ngreh aktakuzë për mashtrim me listat e veteranëve të UÇK-së

PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Një prokuror i EULEX-it ka ngritur një aktakuzë kundër gjashtë të pandehurve. Aktakuza është ngritur në Gjykatën Themelore të Mitrovicës.

Në një komunikatë të lëshuar për medie nga Prokuroria e Shtetit është thënë se të pandehurit akuzohen për veprat penale, posedim i paautorizuar i armëve, mundësim ose detyrim në prostitucion, ushtrim i ndikimit, mashtrim dhe falsifikim i dokumenteve. Policia e Kosovës dhe e EULEX-it është thënë se hetimet i kanë nisur në janar të vitit 2016. Hetimet kanë sjellë deri te zbulimi i një rrjeti ilegal të tregtimit të armëve dhe një sasi të armëve që përbëheshin nga eksplozivë dhe dy armë automatike. "Përveç këtyre, në

posedim të pandehurve ishin kapur edhe disa armë të tjera të ndryshme. Të pandehurit pretendohet se kanë ushtruar ndikim në mënyrë që ta siguronin statusin, më pastaj edhe pensionin e Shoqatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së në këmbim të një pagese deri në një mijë euro. Të pandehurit kësajsoj e kanë dëmtuar buxhetin shtetëror të Kosovës", është thënë në komunikatën e Prokurorisë së Shtetit.

Po në këtë komunikatë është thënë se "një nga të pandehurit ishte përfshirë edhe në shtytjen dhe aranzhimin e marrëdhënieve seksuale me pagesë ndërmjet një gruaje dhe disa burrave, duke përfutur nga kushtet e rënda ekonomike të saj dhe duke përfutur nga kjo veprimtari".

Mbikëqyrja parlamentare fuqizon integritetin e Policisë së Kosovës



Roli i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës është i domosdoshëm për fuqizimin e integritetit të Policisë së Kosovës. Kështu kanë thënë të pranishmit në debatin me temë "Mbikëqyrja parlamentare për Policinë e Kosovës", i cili është organizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) në kuadër të projektit rajonal "Pointpulse"

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 18 PRILL - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) të mërkurën ka mbajtur debatin me temë "Mbikëqyrja parlamentare për Policinë e Kosovës", në kuadër të projektit rajonal "Pointpulse". Me këtë rast hulumtuesi i QKSS-së, Plator Avdiu, ka vlerësuar se kontrolli dhe mbikëqyrja parlamentare ndaj Policisë së Kosovës është shumë e rëndësishme meqë garanton demokratizimin e këtij institucioni. Sipas tij, në këtë drejtim roli i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës është i

domosdoshëm. "Roli i komisionit është i domosdoshëm dhe po shihet se ekziston një bashkëpunim i mirë. Duhet të ngrehën pak më shumë kapacitetet brenda përbrenda Kuvendit. Është mirë të dëgjohet nga deputetët që ka një koordinim të mirë. Besoj se grupi punues do të bëjë punë të mirë. Komisioni duhet t'i shikojë mundësitë që t'i rrisë kapacitetet e veta. Kapacitetet profesionale do të rriten kur komisioni do të japë më shumë kontribut sa i përket profesionalizmit të Policisë së Kosovës, Inspektoratit Policor dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës", ka deklaruar Avdiu. Ndërsa zëvendëskryetari i parë i Komisionit Parlamentar për

Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rexhep Selimi, ka bërë me dije se zbatimi i ligjit ka qenë sfida kryesore. Duke pasur parasysh se problemet në Policinë e Kosovës dhe në Inspektorat janë serioze, ai ka thënë se komisioni do të vazhdojë të punojë seriozisht. "Kur bëhet fjalë për integritet shpresoj se kemi arritur ta bëjmë ndarjen e Policisë së Kosovës dhe problemet që kanë të bëjnë me policinë. Prandaj duhet të jemi të kujdesshëm që Policisë së Kosovës të mos i humbet integriteti", është shprehur Selimi.

Edhe anëtari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe

Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Fatmir Xhelili, ka thënë se Policia e Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës janë dy institucione të besueshme. Ai ka theksuar se policia ka dhënë rezultate të mira dhe të dukshme por, sipas Xhelilit, ka pasur edhe pengesa e çalime. "Jemi të vetëdijshëm që politikën e sigurisë dhe faktori më i rëndësishëm është besimi i qytetarit në polici. Duhet të punojmë në mënyrë që qytetari të vazhdojë të besojë në polici. Integriteti në polici nënkupton një aktivitet i cili duhet të ketë edukime dhe trajnime adekuate për ruajtje dhe rritje të cilësisë së integritetit", ka deklaruar Xhelili.

Kurse përfaqësuesi i Policisë së Kosovës, Brahim Sadriu, ka treguar se është bërë një plan për ta rritur integritetin e Policisë së Kosovës. Sipas tij, ky plan po ecën mirë. Sadriu ka theksuar se një nga vlerat e këtij plani është llogaridhënia dhe, sipas tij, fusha e llogarid-

hënies është një nga aspektet që Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës ndihmon në fuqizimin e integritetit në polici. "Sa i përket planit të integritetit në Policinë e Kosovës jemi duke ecur mirë dhe mbështetja nuk po mungon. Fuqizimi i integritetit në polici lidhet edhe me faktorët e jashtëm në rastin konkret, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka ndikim në fuqizimin e integritetit në polici pasi që Policia e Kosovës raporton te ky komision. Një nga vlerat e planit është llogaridhënia, veprimet tona në terren janë të verifikuara nga një autoritet më i lartë. Bashkëpunimi me komision është shumë i mirë. Fusha e llogaridhënies është një nga aspektet që komisioni ndihmon për fuqizimin e integritetit në polici", është shprehur Sadriu.

Maxhuni kërkon përkrahjen e KFOR-it për anëtarësimin në Interpol



PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, ka pritur të mërkurën në takim komandantin e KFOR-it, gjeneral Salvatore Cuoci, të cilin e ka njoftuar me misionin dhe objektivat strategjike të policisë, për përbashkëpunimin dhe detyrave dhe obligimeve të saj ligjore. "Policia e Kosovës ka kapacitete profesionale dhe është e përgatitur të ofrojë siguri, të luftojë kundër

krimit të organizuar, krimin transkufitar, si dhe të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e sigurisë dhe parandalimit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm", ka thënë Maxhuni.

Ai ka theksuar se Policia e Kosovës ka bashkëpunim të mirë me autoritetet e KFOR-it.

Maxhuni ka kërkuar nga gjeneral Cuoci ta përkrahë Policinë e Kosovës në anëtarësimin e saj në Interpol. Ndërsa komandanti i KFOR-it, gjeneral Salvatore Cuoci, ka konfirmuar se do t'i kushtojë rëndësi vazhdimin të bashkëpunimit dhe përkrahjes, në fusha të ndryshme me interes të përbashkët, duke përfshirë edhe bashkëpunimin në nivel të drejtorëve rajonalë të të dy institucioneve.

Hapet panairi "Prishtina 2018"

Ministri Hasani fton bizneset e huaja të investojnë në Kosovë

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka thënë se Panairi "Prishtina 2018" është një mundësi e mirë për promovimin e ambientit ekonomik të Kosovës si dhe krijon ura bashkëpunimi në mes të kompanive vendore dhe atyre ndërkombëtare

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 18 PRILL - Nën organizimin e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) dhe me përkrahje nga Qeveria e Kosovës, të mërkurën është hapur edicioni i 19 tradicional i Panairit të Përgjithshëm Ndërkombëtar "Prishtina 2018". Panairi mbahet prej datës 18 deri më 21 prill në Qendrën e Panairëve në fshatin Shkabaj, në magjistralen Prishtinë - Mitrovicë.

Në këtë panair prodhimet dhe shërbimet e tyre do t'i ekspozojnë 174 kompani të ndryshme. 88 prej tyre janë nga Kosova, ndërsa 86 të huaja. Këto biznese vendëse dhe ndërkombëtare janë nga sektorë të ndryshëm të prodhimit, përpunimit, bujqësisë, shërbimeve, tregtisë dhe zejtarisë.

Kryetari i OEK-ut, Safet Gërxhaliu, ka thënë se në këtë panair promovohen vlerat e ndërmarrësisë dhe integritimit evropian. Ai ka thënë se beson se nga panairi do të dalë një mesazh për të ndërtuar të ardhmen, që politika të ndahet nga ekonomia. "Agjenda politike në vitet e fundit i ka lënë në hije aktivitetet ekonomike. Sot me praninë e juaj Prishtinën e kemi shndërruar në kryeqytet të Ballkanit Perëndimor për

aktivitete ekonomike. Dua të besoj se nga ky panair do të dalë një mesazh: ta ndërtojmë ardhmërinë e bazuar në edukim dhe sundim të rendit dhe të ligjit", ka thënë Gërxhaliu. Ai ka shtuar se janë këta biznesmenë që kanë pasur guximin ta ndajnë politikën nga ekonomia.

I pranishëm në këtë panair ishte edhe ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, i cili ka thënë se panairi "Prishtina 2018" është një mundësi e mirë për promovimin e ambientit ekonomik të Kosovës si dhe krijon ura të bashkëpunimit në mes kompanive vendore dhe atyre ndërkombëtare. "Ndihehem i nderuar që jam këtu sot në mesin e shumë kompanive vendore dhe ndërkombëtare që po marrin pjesë në këtë panair. Panairi 'Prishtina 2018' është një mundësi e mirë për promovimin e ambientit ekonomik të Kosovës dhe besoj se do të shërbejë për krijimin e urave të reja të bashkëpunimit në mes të kompanive vendore dhe atyre të huaja, përmes bizneseve dhe konsumatorëve. Gjatë kohës sa do të mbahet panairi kompanitë kanë mundësi t'i tregojnë arrijtet e tyre. U bëj thirrje kompanive ta shfrytëzojnë mundësinë që ua jep ky panair. Ne jemi të vetëdijshëm se zhvillimi ekonomik i Kosovës mund të



arrihet vetëm përmes partneritetit dhe bashkëpunimit mes sektorit privat, institucioneve

tona dhe investitorëve të jashtëm. Pra, sot ekonomia e Kosovës është në një nivel tjetër

të zhvillimit me atë që ka qenë para disa vjetësh", ka thënë Hasani.

Ministri Hasani ka theksuar se në MTI kanë nisur reformat për ta krijuar një ambient edhe më të mirë për të bërë biznes. Ai ka folur edhe për masat mbrojtëse që janë marrë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në mbrojtje të prodhimeve vendore. Ministri Hasani ka siguruar të gjithë prodhuesit se do ta kenë përkrahjen maksimale për ta forcuar ushtrimin e veprimtarisë së tyre tregtare. Hasani ka paralajmëruar edhe masa të tjera mbrojtëse edhe për sektorët e tjerë nëse konstatohet se ka shkelje të ligjit.

Kundërshtohet hapësira e madhe e produkteve të Serbisë në panairin "Prishtina 2018"

Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje kanë shprehur shqetësimin në lidhje me pjesëmarrjen e produkteve të Serbisë në panairin ndërkombëtar "Prishtina 2018".

Shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, ka folur për hapësirën e madhe që u është dhënë produkteve të Serbisë si dhe vërshimit të këtyre produkteve në tregun e Republikës së Kosovës, pavarësisht se Serbia e lufton në çdo drejtim Republikën e Kosovës si në arenën ndërkombëtare, po ashtu edhe përmes strukturave paralele përbrenda Kosovës. "Nga 174 biznese të

cilat marrin pjesë në këtë panair, 70 prej tyre janë nga Serbia dhe vetëm një është nga Republika e Shqipërisë. Kjo tregon se institucionet e Kosovës dhe Oda Ekonomike e kanë shndërruar Kosovën në një koloni tregtare të Serbisë", ka thënë Konjufca. Ai ka potencuar edhe nivelin e lartë të importit tregtar me Serbinë, e cila kalon shifrën prej gjysmë miliard eurosh, ku nga 19 vjet të pasluftës produktet e Serbisë në mënyrë shtetërore janë bojkotuar vetëm 45 ditë.

d ta ndryshojmë këtë", ka theksuar ai.

Ministri i Diasporës dhe

Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, e ka falënderuar atë për punën që "Stone Castle" po bën, ndërsa e ka informuar edhe për parametrat mbi të cilët funksionon Ligji për Investime Strategjike në Kosovë. "Stone Castle" po bën një punë të mrekullueshme. Tash, me ligjin për investime strategjike, do t'i shikojmë modalitetet e projektit të propozuar, më pas do t'i vazhdojmë edhe takimet që të arrihet një rezultat i kënaqshëm për të dyja palët", ka thënë Gashi.

"Stone Castle" eksporton verën dhe verakun në Kanada, Norvegji, ShBA dhe në shtetet e BE-së.

Kabineti qeveritar injoron debatin në Kuvend për mishin e prishur

PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Kuvendi i Kosovës të mërkurën ka mbajtur debat rreth skandalit për mishin e prishur dhe cilësinë e ushqimit në Kosovë. Në këtë seancë nuk ishin të pranishëm kryeministri dhe asnjë ministër. Madje deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Adem Mikullovi, në fjalën e tij ka përshëndetur ministrat që nuk janë të pranishëm. "Përshëndes ministrat kudo qofshin", ka thënë Mikollovi me ironi.

Debati parlamentar për këtë temë është iniciuar nga deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, bashkë me deputetët e pavarur. Deputetja Musliu në

fjalën e saj ka propozuar rekomandimet që duhet të marrë Kuvendi i Kosovës përmes votimit të një rezolute: 1) Të bëhet plotësim-ndryshimi i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, i cili në mënyrë formale-juridike mundëson transferimin e të gjithë inspektorëve përkatës dhe kompetentë nga niveli lokal tek niveli qendror; 2) Mbështetje më të madhe buxhetore për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë për realizimin e mandatit të saj, në veçanti të ndahet buxhet në mbështetje me linjat e caktuara për pajisjet e nevojshme dhe të sofistikuara për trupat inspektuese për mbështetjen e kon-



trolleve zyrtare; 3) Nuk duhet në asnjë mënyrë të anashkalohehet as Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë si njësi e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Ky laborator ka nevojë sistematike për furnizim

të pajisjeve, mirëmbajtje të pajisjeve dhe reagjentëve laboratorikë; 4) Avancimin e mëtejshëm të metodave testuese në përputhje me standardet dhe kërkesat e kohës, ku rezultatet e tij janë tregues i performancës

së kontrolleve zyrtare nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë përmes mostrave zyrtare dhe sistemeve të vetëkontrollit nga operatorët e biznesit me ushqim përmes mostrave të vetëkontrollit; 5) Taxisim bashkëpunimin nga niveli qendror tek ai lokal për konsolidimin e Zyrave Regionale të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë; 6) Të zhvillojmë kampanja vetëdijësuese për qytetarët që të jenë sa më të kujdesshëm për ushqimet që zgjedhin t'i konsumojmë; dhe 7) mbështetja e Agjencisë me personel profesional, konkretisht me inspektorë e veterinarë.

Kosova e gatshme për nismat rajonale në fushën e digjitalizimit

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në Samitin Digjital të Ballkanit Perëndimor, i cili po mbahet në Shkup, ka theksuar se teknologjia informative dhe komunikimi janë tejet të rëndësishme për zhvillimin ekonomik

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

SHKUP, 18 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të mërkurën në Samitin Digjital të Ballkanit Perëndimor, që për herë të parë po organizohet në Shkup të Maqedonisë. Në fjalën e tij drejtuar pjesëmarrësve të samitit, kryeministri Haradinaj ka theksuar se organizimi i këtij samiti është një hap tejet i rëndësishëm për ta çuar përpara vizionin e integritimit dhe bashkëpunimit në mes të vendeve të Ballkanit dhe tregut digjital evropian. "Kosova konsideron se teknologjia informative dhe komunikimi janë tejet të rëndësishme për zhvillim ekonomik. Ne jemi angazhuar që të kemi qasje në ICT dhe në bashkëpunim me Bankën Botërore jemi duke e përgatitur programin KODE (Ekonomia Digjitale) dhe jemi të bindur që iniciativa Balkans Digital Highway do ta fuqizojë edhe më tepër bashkëpunimin rajonal. Ajo që është e rëndësishme për ekonominë tonë, është se Qeveria jonë është duke punuar që të kemi koordinim rajonal për një zonë të lirë ekonomike në roaming dhe në bashkëpunim me vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova ka iniciuar nismën për marrëveshjen e Roamingut Regjional", ka deklaruar Haradinaj në fjalën e tij hyrëse.

Kryeministri ka përmendur edhe faktin që në Kosovë është krijuar një politikë dhe infrastrukturë e avancuar për informimin dhe teknologjinë informative, ku



rreth 86 për qind e banorëve kanë qasje në rrjetin telefonik dhe të internetit 3G apo 4G dhe vendi ka shënuar trend të mirë të avancimit në pesë vjetët e fundit, derisa Kosova është duke përgatitur rrugën për qasje në rrjetin e edukimit dhe hulumtimit GEANT.

Pjesë e panelit të Samitit Digjital të Ballkanit Perëndimor, nikoqiri i të cilit është kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, përveç kryeministrit të Kosovës,

Ramush Haradinaj, ishin edhe Denis Zvizdic, kryesues i Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Thomas Bareis, sekretar parlamentar i shtetit, Ministria Federale për Çështje Ekonomike dhe Energji, Republika Federale e Gjermanisë, zëvendëskryeministria e Shqipërisë, Senida Mesi, ministri i Ekonomisë i Malit të Zi, Dragica Sekulic, komisionarja evropiane për Ekonominë Digjitale dhe Shoqëri, Mariya

Ivanova Gabriel, derisa moderohet nga sekretari gjeneral i RCC-së, Goran Svilanovic. Avancimi digjital i vendit është edhe përafrimi i Kosovës me platformën evropiane, derisa ka impakt të drejtpërdrejtë në ekonominë e qëndrueshme të vendit, qeverisjen e mirë, zhvillimin social, edukim dhe shkencë, shëndetësi dhe në energji të qëndrueshme. Kosova është e përkushtuar të jetë në hap me të gjitha

avancimet teknologjike duke bashkëpunuar me vendet e rajonit dhe duke u përafruar sa më shumë me familjen evropiane. Samiti Digjital i Ballkanit Perëndimor ka bërë bashkë përfaqësues të lartë të vendeve të Ballkanit Perëndimor, koordinatorët regionalë, shoqërinë civile dhe akademike, të rinjtë dhe ka për qëllim të këmbëjë ide dhe propozime në mes të vendeve pjesëmarrëse.



Ndahen 30 certifikata për të rinjtë e Shoqatës 'Down Syndrome Kosova'

PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Zëvendëskryeministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Vesel Makolli, ka marrë pjesë në ndarjen e 30 certifikatave për të rinjtë me Sindromën Down, në kuadër të projektit "Fuqizimi i të rinjve me Sindromën Down", projekt ky i nënshkruar muaj më parë në mes të kësaj ministrie dhe Shoqatës "Down Syndrome

Kosova". Synimi i këtij projekti ishte përkrahja dhe zhvillimi i trajnimeve profesionale për të rinjtë me Sindromën Down, më pastaj duke mundësuar edhe punësime për nevojat e kësaj kategorie në shoqërinë tonë. Këto trajnime janë mbajtur në tri qendrat më të mëdha të aftësisimit profesional në Kosovë, Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë.

Gashi dhe Bahtiri flasin për situatën e sigurisë në Mitrovicë

PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, me të cilin kanë diskutuar për situatën e sigurisë në Kosovë, në veçanti në komunën e Mitrovicës. Me këtë rast ministri Gashi ka ofruar gatishmërinë e tij të plotë dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme në mbështetje të Komunës së Mitrovicës, duke vënë në pah se bashkëpunimi mes nivelit qendror dhe lokal është shumë i rëndësishëm në

shërbim të qytetarëve.

Ndërsa kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, e ka informuar ministrin Gashi lidhur me sfidat me të cilat ballafaqohet Komuna e Mitrovicës sa i përket situatës së sigurisë dhe për çështjet me të cilat do të mund të mbështetet niveli komunal nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në këtë takim u diskutua edhe për përmirësimin e shërbimeve të gjendjes civile në kuadër të sistemit të unifikuar të gjendjes civile dhe mundësisë për mbështetje të projekteve konkrete.



Fillon ndërtimi i serrave për bujqit e Malishevës

MALISHEVË, 18 PRILL (ER) - Në kuadër të subvencioneve në bujqësi, në Komunën e Malishevës ka filluar realizimi i projektit për ndërtimin e serrave për bujq. Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka thënë se ndërtimi i serrave është pjesë e subvencioneve për fermerët të cilët kanë nevojë për përkrahje. "Njëkohësisht ky është realizim i një prej prioriteteve tona, pasi bujqësia është sektori kyç i zhvillimit ekonomik tek ne, në të njëjtën kohë, krahas rritjes së mirëqenies për këto familje, rritet mundësia e furnizimit të tregut me

produkte vendore", ka thënë Begaj. Ndërsa drejtori për Bujqësi, Murat Hoxha, ka sqaruar se në këtë projekt përfitues të serrave janë 35 bujq nga Komuna e Malishevës. "Ne po përpiqemi që të gjitha planifikimet tona t'i realizojmë dhe ky është prej prioriteteve që ka Drejtoria për Bujqësi. Në këtë projekt përfitues do të jenë 35 bujq, ndërsa ndërtimi i serrave është një vazhdimësi nga vitet e kaluara dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen, pasi përmes kësaj familjet përfituese po krijojnë edhe të hyra, gjithashtu po ulet shkalla e papunësisë", ka thënë Hoxha.



Shënohet 20-vjetori i themelimit të njësitit të parë të UÇK-së

MITROVICË, 18 PRILL (ER) - Në fshatin Zabërgj është shënuar 20-vjetori i themelimit të njësitit të parë të UÇK-së në Shalë të Bajgore. Në këtë manifestim kanë marrë pjesë kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, përfaqësues të institucioneve, pjesëtarë të FSK-së,

ish-pjesëtarë të UÇK-së, përfaqësues të shoqatave të luftës, si dhe banorë të rajonit të Shalës.

Në fjalën e tij kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë se para 20 vjetësh trimat e kësaj ane i treguan armikut se durimit i ka

ardhur fundi, duke kapur armët në duar për t'i dalë zot atdheut. Ndërsa Rafet Ibishi, kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës në Mitrovicë, ka theksuar se sa herë që përmendet e kaluara, kujtohet rruga nëpër të cilën kaluan luftëtarët për të arritur deri në ditët e sotme.



Nderohen dëshmorët Bega e Islami

FERIZAJ, 18 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, i shoqëruar edhe nga nënkryetari Naim Ferati, deputeti i PDK-së, Elmi Reçica, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, famil-

jarë dhe qytetarë, kanë bërë homazhe të mërkurën te varrezat e dëshmorëve në nderim të dëshmorëve Sadik Bega-Mortaja dhe Driton Islami-Toni. Me këtë rast, Luan Jahiri nga Organizata e Vetëanëtarëve të

Luftës së UÇK-së ka vlerësuar lart kontributin e dëshmorëve, duke cilësuar veprën e tyre si të pavdekshme. Me homazhe janë nderuar edhe 62 dëshmorët e tjerë të Komunës së Ferizajt.

Ilazi: Infrastruktura shkollore, parakusht për ngritjen e cilësisë në arsim

Kaçanik, 18 prill (ER) - Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, dhe drejtori i Arsimit, Zahir Doda, kanë vizituar të mërkurën objektet shkollore që janë në ndërtim e


sipër në fshatin Glloboqicë dhe Kovaqec të kësaj komune. Me këtë rast, Ilazi është shprehur i kënaqur me ecurinë e punimeve në këto objekte shkollore, duke shtuar se rreg-

ullimi i infrastrukturës shkollore është parakusht për ngritjen e cilësisë në arsim. Ndërtimi i objekteve të reja shkollore në fshatrat Glloboqicë dhe Kaçanik të

Vjetër është duke u mbështetur financiarisht nga Ministria e Arsimit, ndërsa objekti shkollor në fshatin Kovaqec është duke u ndërtuar nga mjetet komunale.



Shkodra budallaqe apo budallenjtë e Shkodrës



Bedri ISLAMI

Prallëherë kam njohur një qytet të mençur si Shkodra. Kam shkruar më herët se Shkodra është kryeqyteti i mendjes. Në qytetet e ndryshme të Kosovës kam dëgjuar shpeshherë se, si thoshin të vjetrit, perëndia kur i ndau mendtë njerëzisë, tri hise i la në Shkodër dhe pjesën tjetër në të gjithë dynjanë.

Shkodra është e bukur gjithnjë, sidomos në pranverë. Ndoshta ka dhuntitë e falura bujarisht; tre lumenjtë që e rrethojnë e pak më tej liqeni, të gjitha nën gjelbërimin e stinës të duken se kanë bërë rrethimin e gjelbër; ndërsa Maranai e Cukali, ende të zbardhur kanë ende pjesën e tyre në ditët e pranverës.

Të gjitha këto ia dhashë vetes këto ditë në Shkodër.

I thashë edhe shumë gjëra të tjera, por fjalën nuk e kam për një reportazh. Ndoshta koha ua përpiu hapësirën reportazheve. Është budallaqe Shkodra që ndryshe nga shumë qytete të tjera vazhdon të quajë veten bastion i vetëm një force politike, apo si ndodh rëndomë, kjo është një sëmundje politike e budallenjve të Shkodrës?

Vërtet është Shkodra skajmërisht e djathtë, e palëvizur nga e djathta, strehë e çdo lëvizje politike në të kundërtën e saj, apo një dorë jashtë saj, e barazlanguar nga "Sheshi i Dëshmorëve" e kërkon këmbulshmërisht këtë qytet si një peng i mendimit të shumëllojshëm, të lirë dhe plot dritë?

Ky nuk është një mendim i tashëm. E kam bluar prej kohësh: më saktë e kam pasur në vete që nga 2 prilli i vitit 1991, kur në njërën nga sheshet e qytetit mbetën të vrarë katër veta, tre djem të rinj dhe një burrë, dy nga të cilët i kisha njohur e njërin prej tyre, Arben Brocin, i kishim dritaret ballë

njëri-tjetrit; më saktë, dritaret e fisit të Brocërve binin në oborrin e shtëpisë ku unë banoj edhe sot e kësaj dite, ashtu si fisi i tij banon ende aty.

Më 2 prill të vitit 1991 isha një kohë në atë shesh. Jo si demonstrues, sepse edhe ata që e quajtën veten të tillë, vetëm demonstrues nuk ishin. Asaj dite pata njohur nga afër Ded Kasnecin, i cili i tha të njohurit të tij se "o do e djegim sot Komitetin e Partisë, ose unë do të varrosem". I njohuri i tij, Shaqir Vukaj, me të cilin isha, i pat thënë se nuk është nevoja as të digjet dhe as ai të varroset, se gjërat mund të zgjidhen me mend e jo me zjarr, por fitili ishte ndezur me kohë dhe pritej vetëm shpërthimi.

Në këtë 2 prill isha përsëri në Shkodër. Megjithëse zakonisht nuk jam njeri i kafeneve, isha ulur në mjediset luksoze Grand Hotel Europa, pronë e deputetit të LSI-së, Agron Çela. Isha ulur dhe nuk e dija se pas pak aty do të mbahej një meeting, ritual i çdovtshëm dhe se do të kisha "fatin" të ndiqja nga larg "liderin" pëdëist, Basha.

2 prilli i këtij viti ishte njësurrogato e 2 prillit të vitit 1991. Një pamje e turpshme e mjerimit politik dhe e braktisjes. Një shesh që nuk ishte mbushur as në një të dhjetën e tij, përgjithësisht njerëz të lodhur, të shtyrë nga një tufë deputetësh, që tashmë nuk kishin as forcën dhe as energjinë për të përkrahur liderin e ardhur nga Tirana.

I shihja ata njerëz që prisnin në shesh, ishte vapë e parakohshme, por gjithsesi asgjë nuk i ngrohte. As zëri i sforcuar i Bashës, që u premtonte se, ja,

edhe pak ditë qeveria Rama do të përmbysset, se, ja, edhe pak do të duronin...se Shkodra ishte themel e shkuar themelit, se nga Shkodra ka nisur gjithnjë fitorja e revolucionit dhe se, ja...mbaroi. Kujt i fliste ai njeri me atë zë të lodhur nga padija? Jam i bindur se menjëherë pasi ka kaluar urën e parë të qytetit as nuk është kujtuar më për Shkodrën e as për heronjtë e demokracisë, ashtu si jam i bindur se nëse dikush e pyet sot për emrat e tyre, shumë - shumë, ai mund të sjellë ndër mend vetëm dy prej tyre.

E megjithatë, ai e grishte qytetin të ngrihej, të shpallte revolucionin e tij, të marshonte drejt Tiranës, ku rrinë këllqet e lodhura të tij dhe të plakut politik renegat; ai kërkonte rishtas nga Shkodra kurbanët e tjerë, të tjerë emra, dhe, përmes tyre, si ndodhi me të rënë të 2 prillit, të ndërtojë pushtetin e tij.

Shkodra e mençur qëndronte nën hijen e blirëve, një tufë meetingash, mes tyre deputetët meetingash, kërkonin budallallëkun e saj.

Kisha qeshur me vete kur kisha dëgjuar një drejtues të deleguar komune, pas përmbytjeve, se Shkodra duhet të veprojë si Katalonja. Të jetë e mosvarme nga pushteti dhe, ai, karabush i thonë në Shkodër, kishte renditur se, Shkodra ka hidrocentralet, sikur të ishin në xhepin e tij, ka minierat, sikur të jenë korpusi i pasurisë së tij. Kisha qeshur, sepse kudo mund të gjejmë të tillë. Në prillin e vitit 1991, kur kisha dëgjuar thirrjet, "Shkodra - Republikë", që filmoheshin vetëm nga kamarat e mediave malazeze e serbe, nuk kisha

qeshur. Kam pasur brenda vetes një peng dhe shtrëngim, pasi e dija se në atë çast, numri meetingash po sundonte mbi mendjet e zgjuara të Shkodrës. Kisha pritur gjatë që kjo dalldi e paguar jo keq...pas 2 prillit lindën shoqata të fuqishme pro serbe...të kisha fundin e saj dhe jo rastësisht qesha me vete, kur dëgjoja se një anamalasi donte ta bënte Shkodrën si Katalonja.

Dhe kur mendova se mençuria ishte më e fuqishme se sa mediokriteti, dhe në fakt është, pashë në qendrën e qytetit një grusht njerëzish, ndoshta 50 vetë a diçka më shumë që të mbledhur rreth deputetësh dhe Zonjës së Parë të Bashkisë, bërtisnin "Rama ik", kur ai ende nuk kishte ardhur, dhe në fund xhevahiri bashkiakes se "Shkodra e ka shpallur Edi Ramën person non grata".

E dëgjuar në rrugë nga të mllëfosur edhe hahet. Mllëfi është këshilltar i keq, por vjen një ditë dhe bie. E thënë nga kryetarja e Bashkisë, me atë seriozitetin e budallashëm në të tilla raste, e ngrefosur sikur kishte dhënë gjëmën për pushtetin, më erdhi keq. Jo për qytetin tim, i cili përmes bojkotit, e kishte shpallur "non grata" kryetaren e tij, por për vetë atë, Zonjën, që e kisha marrë në mbrojtje publikisht në një debat të saj me shefin e qeverisë.

E di se tani në pragun e zgjedhjeve bashkiake, duhet dëshmuar besnikëri, por, pyetja e parë që i bëhet: kush jeni ju që, për hir të politikës, me cilin tagër, shpallni "nën grata", shefin e qeverisë?

Cilët qytetarë keni pyetur? Cili

referendum është bërë?

Matematika e thjeshtë e dy zgjedhjeve të fundit parlamentare ka nxjerrë forcë të parë linjën e së majtës në hartën elektorale të Shkodrës, por edhe nëse do të ishte ndryshe, cilën kërrabë tërheq pas vetes?

Thirrjet halucionante për t'ia mbyllur dyert shefit të qeverisë, se mos iu pyet njeri se kur vjen e kur shkon, ngazëllimi se ja nuk po vjen, sonetat nën dritën e hënës për fitore, cilën?, përpjekja e dëshpëruar për të krijuar për banorët e qytetit imazhin e njerëzve antishitet, të gjitha janë me një fillësë të vitit 1991 dhe katër vrasjet ende të mbetura nën hijen e dyshimit.

Thirrjet për të ndarë veriun nga jugu, krijimin e një ndasie të re, jo vetëm politike, nuk janë pjesë e qytetit. Ka qenë gjithnjë një qytet i mençur që e ka ditur të vërtetën.

Vërtet Shkodra ju ka zgjedhur, por që të jeni me mend, jo të bëni një lojë faqekeqe deri sa edhe harresa do të ishte e largët. Shkodra nuk është budallaqe. Edhe nëse ajo një ditë, që nuk do të vijë kurrë, do të votonte e gjitha për të djathtë, përsëri ajo mbetet një rilindje e mendimit të hapur.

Budallenjtë duan ta tërheqin pas vetes. Të zemëruar se gropa e hapur në vitin 1991 është drejt mbushjes, duan me çdo kusht, ta përplasnin edhe një herë mendjen e qytetit me budallallëkun e verbërisë së tyre. Do të jetë e kotë. Ujërat nuk rrjedhin dy herë në të njëjtin vend.

Vetëm budallenjtë dhe të shiturit rrahin në të njëjtin ujë. Shoh edhe tani, në këtë çast, lulet e qershive që kanë çelur. Shkodra nuk është e vitit 1991. Asaj kohe ishte derdhur dufi i një epike që pritej ndaj asaj që po shkante.

Shkodra atëherë bëri zgjedhjen e saj. Nuk kishte qenë as qyteti më i vuajtur, as më i prangosur, as më antikomunisti, as më identiteti, as më hekakeqi.

Kishte qenë një qytet nën diktaturë, si e gjithë Shqipëria. Tani, 27 vjet më pas, raportet kanë ndryshuar. Kush nuk e di këtë të vërtetë, ka ende rrugë për të bërë drejt mendjes.



Përkujtohen dëshmorët e Prishtinës

PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Të mërkurën është shënuar 19-vjetori i dëshmorëve të rënë për liri në kryeqytet, ku shumë zyrtarë të Komunitetit të Prishtinës dhe veteranë të luftës kanë bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve në lagjen "Velania".

Në ditën e përkujtimit të dëshmorëve në lagjen "Velania" ka

bërë homazhe edhe kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, i cili ka thënë se dëshmorët kanë dhënë më sublimen për lirinë e vendit.

Ahmeti nuk la pa e përmendur edhe gjendjen e infrastrukturës së këtyre varrezave, duke thënë se komuna ka bërë kërkesë te Ministria e Mjedisit dhe

Planifikimit Hapësinor që t'i marrë përsipër varrezat e dëshmorëve, pasi ministria ka ngecur me rregullimin infrastrukturor. Ndërsa kryetari i Veteranëve të Luftës në Prishtinë, Fatmir Sopi, ka thënë se dëshmorët kanë dhënë kontributin e tyre në maksimum dhe janë gurthemeli i lirisë.



Ndërron jetë Barbara Bush

UASHINGTON, 18 PRILL - Barbara Bush ishte gruaja e një presidenti të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe nëna e një tjetri. Barbara Bush ishte bashkëshortja e ish-presidentit të Shteteve të

Bashkuara të Amerikës, George H. W. Bush, i cili shërbeu nga viti 1989 deri në vitin 1993, si dhe nëna e George W. Bushit, i cili ishte president nga viti 2001 deri në vitin 2009.

Lajmi për vdekjen e saj u dha nga një zëdhënës i familjes Bush, i cili tha se kohët e fundit ajo kishte pasur probleme të ndryshme shëndetësore, por kishte vendosur të mos kërkonte trajtim mjekësor shtesë.



Trumpi konfirmon takimin sekret Pompeo-Kim në Phenian

Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se takimi i shefit të CIA-s, Mike Pompeo, me liderin verikorean Kim Jong Un ka ndodhur javën e kaluar në Korenë Veriore

UASHINGTON, 18 PRILL - Presidenti amerikan Donald Trump ka konfirmuar se shefi i CIA-s, Mike Pompeo, është takuar me liderin verikorean, Kim Jong Un, në javën e kaluar. Përmes një postimi në "Twitter" ai ka thënë se takimi ka ndodhur në Korenë Veriore. "Takimi është zhvilluar lehtë dhe janë krijuar marrëdhënie të mira. Është duke u punuar në detajet e samitit. Denuklearizimi do të jetë gjë fantastike për botën, por edhe për Korenë Veriore", ka thënë Trumpi.

Raportimet për takimin në mes të Kimi dhe Pomepos janë bërë të ditura më 17 prill nga gazeta "The Washington Post", e cila ka thënë se të dy janë takuar në një vizitë sekrete në Korenë Veriore gjatë fundjavës së Pashkëve. Raporti ka cituar dy individë "me njohuri të drejtpërdrejta për udhëtimin".

Agjencia e lajmeve "Reuters" ka cituar më pas një zyrtar të lartë amerikan duke konfirmuar se

Pompeo është takuar me Kimin. Trumpi, që ka nominuar Pompeo për ta zëvendësuar ish-Sekretarin e Shtetit, Rex Tillerson, ka thënë më 17 prill se Uashingtoni dhe Phenjani kanë zhvilluar bisedime të drejtpërdrejta "të nivelit tejet të lartë", në tentim të planifikimit të samitit me Kimin. "Ne kemi pasur biseda të drejtpërdrejta të nivelit të lartë, tejet të lartë me Korenë Veriore", ka thënë Trumpi derisa ka mirëpritur kryeministrin

japonez, Shinzo Abe, në një samit dyditor në Florida. "Unë besoj se kjo i jep hapësirë qëllimit të mirë sepse janë duke ndodhur gjëra të mira. Do të shohim se çfarë do të ndodhë", ka thënë ai.

Para raportimeve për takimin Pompeo-Kim ka ekzistuar një konfuzitet rreth asaj se të cilin nivel kanë qenë bisedimet në mes të Uashingtonit dhe Phenjanit.

Derisa Trumpi ishte me kryeministrin Abe dhe gruan e tij, një gazetar e ka pyetur presidentin



amerikan nëse ai ka folur drejtpërdrejta me Kimin.

Trumpi është përgjigjur "po", mirëpo ende nuk është bërë e qartë nëse ai i është përgjigjur pyetjes apo dikush tjetër është përgjigjur në vend të tij.

I pyetur disa minuta më vonë për të qartësuar nëse ai ka biseduar me Kimin, Trumpi është përgjigjur se janë zhvilluar bisedime të nivelit të lartë. Abe ka komentuar "kurajën" e Trumpit për t'u takuar me Kimin pas disa muajsh të retorikës së nxehtë lidhur me programin bërthamor të Phenjanit.

Trumpi ka thënë se pesë vende janë duke u konsideruar për mbajtjen e takimit historik ShBA - Kore Veriore, për të cilin ai shpreson se do të ndodhë në muajt vijues. "Takimi mund të ndodhë në fillim të qershorit ose para asaj kohe, me shpresën se gjërat do të shkojnë mirë", ka thënë ai. "Është e mundshme që situata të mos jetë e mirë dhe të mos ndodhë takimi andaj ne do të vazhdojmë rrugën e ashpër që tashmë e kemi marrë", tha Trumpi. Ai ka konfirmuar se të dy Koretë janë duke negociuar dhënien fund të armiqësisë para

takimit të planifikuar në mes të liderit verikorean dhe presidentit jugkorean javën e ardhshme.

Trumpi ka thënë se ai mbështet përpjekjet në mes të Seulit dhe Phenjanit me qëllim të dhënies fund të gjendjes së luftës në mes të dy shteteve e cila vazhdon nga viti 1953. "Ata e kanë bekimin tim për ta diskutuar përfundimin e luftës. Njerëzit nuk e kuptojnë se Lufta Koreane nuk ka përfunduar. Është duke vazhduar edhe tani. Ata janë duke diskutuar tani përfundimin e luftës. Ata e kanë bekimin tim për të diskutuar këtë marrëveshje", ka thënë Trumpi.

Qëllohet ekipi faktmbledhës i OKB-së në Douma



DAMASK, 18 PRILL - Një ekip i sigurisë i Kombeve të Bashkuara u qëllua me armë zjarri ndërsa po heton faktet në Douma të Sirisë, në vendin ku dyshohet se është kryer një sulm me armë kimike, njoftuan burime të Kombeve të Bashkuara. Sipas të njëjtave burime, asnjë prej anëtarëve të ekipit nuk u dëmtua dhe ata u kthyen në kryeqytetin Damask. Inspektorët e Mbikëqyrësit Ndërkombëtar të Armëve

Kimike janë ende në pritje për të hyrë në Douma, për të përcaktuar nëse në një sulm të këtij muaji, ku u vranë dhjetëra veta, janë përdorur armë kimike.

Të martën pati paqartësi nëse ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë kishte mbërritur në këtë zonë. Televizioni shtetëror sirian dhe grupi i shpëtimit vullnetar i Helmetat e Bardha thanë se në deklarata të veçanta se ekipi faktmbledhës nga Organizata për

Ndalimin e Armëve Kimike kishte ardhur në Douma. Të martën pasdite një zëdhënës e Departamentit Amerikan të Shtetit i kundërshtoi këto njoftime.

ShBA-ja dhe aleatët e tyre fajësojnë regjimin e Bashar al-Assadit për sulmin vdekjeprurës me armë kimike. Ndërkohë Rusia dhe Siria thanë se në Douma nuk ka pasur asnjë sulm me armë kimike.

Turqia në qershor mban zgjedhjet e parakohshme

ANKARA, 18 PRILL - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka thënë se zgjedhjet në Turqi do të mbahen më 24 qershor, më shumë se një vit më herët sesa që ishin planifikuar fillimisht. Ai ka thënë se shteti ka nevojë urgjente për kalim në presidencë ekzekutive. Sipas tij, një ndryshim i tillë është i domosdoshëm për të ardhmen e shtetit.

Erdogani ka njoftuar për këtë vendim pasi ka biseduar me udhëheqësin e partisë nacionaliste, MHP, Devlet Bahçeli. "Ndonëse presidenti dhe Qeveria janë duke punuar për harmonizim, sëmundja e sistemit të vjetër po na konfronton në çdo hap", ka thënë Erdogan në një fjalim televiziv. "Zhvillimet në Siri dhe vende të tjera e kanë bërë urgjente ta ndryshojmë sis-

temin ekzekutiv në mënyrë që të marrim vendime për të ardhme më të fuqishme të shtetit tonë. Ne kemi diskutuar thirrjen e Bahçelit me autoritetet relevante. Ne kemi ardhur në përfundim se duhet t'i konsiderojmë pozitive zgjedhjet e reja", tha ai. Vitin e kaluar Erdogan ka fituar një referendum për ta ndryshuar kushtetutën dhe për krijimin e presidencës ekzekutive.



Shënohet Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Lokaliteteve

PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka shënuar të mërkurën Ditën Ndërkombëtare të Monumenteve dhe Lokaliteteve.

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Lokaliteteve po shënohet në kuadër të vitit të trashëgimisë kulturore evropiane, duke inkurajuar me shumë angazhim në mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore si vlerë e përbashkët.

Për ta shënuar këtë ditë, në Parkun Arkeologjik u promovuan tri botimet e Institutit Arkeologjik të Kosovës: Harta Arkeologjike e Kosovës, vëllimi i III-të, Trashëgimia Arkeologjike e Komunës së Istogut dhe Trashëgimia Arkeologjike e Komunës së Skenderajt. "Jemi së bashku për t'i promovuar tri botimet e Institutit Arkeologjik të Kosovës, paraprakisht edhe angazhimin e arkeologëve, profesionistëve, komunave që kanë bashkëpunuar me institucionet



tona gjatë procesit të evidentimit të lokaliteteve, ekspeditave të ndryshme me karakter të përmjohjes dhe atë shkencor. Puna e Institutit Arkeologjik të Kosovës, në bashkëpunim me arkeologë të tjerë të vendit dhe ndërkombëtarë, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka mundësuar në vazhdimësi dokumentimin e të kaluarës sonë, thesartit të trashëgimisë dhe qytetërim-

it të hershëm", ka thënë ministri Gashi. Ai tha se përkushtimi për ta mbështetur punën shkencore të Institutit Arkeologjik dhe institucioneve e profesionistëve do të vazhdojë. "Rëndësi më e madhe do t'i kushtohet angazhimit të kuadrove të reja në fushën e arkeologjisë, kurse fokus të përbashkët do t'i kemi botimet dhe prezantimet e rezultateve brenda dhe jashtë vendit", u shpreh ministri



Gashi. Në shënim të kësaj dite, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ndau tri mirënjohje për përfaqësuesit e familjeve të cilat kanë dhënë kontribut në fushën e trashëgimisë arkeologjike duke i dhuruar gjetjet arkeologjike.

Mirënjohjet u ndanë për familjen e Faik Islamit nga fshati Gllamnik, Komuna e Podujevës, familjen e Hamdi Ibishit, fshati Orllan,

Komuna e Podujevës dhe për familjen e Prend, Nikollë e Pjetër Heqimit, fshati Zllakuqan, Komuna e Klinës.

Në përmbyllje të fjalës së tij, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, falënderoi për kontributin e jashtëzakonshëm të gjithë arkeologët, redaksinë e Hartës Arkeologjike, autorët, si dhe autorin e dy botimeve, Haxhi Mehmetaj dhe komunitat përkatëse.



Kosova dhe Shqipëria vazhdojnë prezantimin e përbashkët në festivalin e Kanës

PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK), bashkë me atë të Shqipërisë, do të jenë pjesë e tregut të madh "Marche Du Film" të festivalit prestigjioz të Kanës nga data 8 deri më 17 maj. Këtë vit lokacioni i pavijonit do të jetë në një hapësirë më të mirë

dhe pranë shteteve me industri më të zhvilluar të filmit. Pavijoni do të jetë i vendosur afër shteteve të Evropës Juglindore, Republikës Çeke, Sllovakisë, Amerikës, Gjermanisë etj.

Në "Marche Du Film" do të prezantohen të rejtat e kinematografisë së

Kosovës si me anë të katalogut, po ashtu edhe duke i prezantuar të gjithë filmat e mbështetur nga QKK-ja para producentëve ndërkombëtarë, përfaqësuesve të fondeve të filmit, të festivaleve, agjentëve të shitjes, distributorëve etj.

Gjatë qëndrimit në Kanë do të mbahen shumë takime me partnerë ndërkombëtarë të kinematografisë, fonde filmi, përfaqësues të festivaleve të mëdha ndërkombëtare, producentë e distributorë të ndryshëm, ku edhe pritet të nënshkruhen disa marrëveshje.

Kulla e Luan Krasniqit, pjesë e trashëgimisë kulturore

JUNIK, 18 PRILL (ER) - Në mbledhjen e radhës të Këshillit të Qeverisë Komunale të Junikut është vendosur të hyjnë në objektet e mbrojtjes së trashëgimisë historike dhjetëra kulla, në mesin e të cilave janë: Kulla e Brahim Sadikut - Krreku, Ali Bajraktarit, Avdullah Salihit si dhe Kulla e Sali Islamve - pinjoll i së cilës është boksieri i mirënjohur junikas Luan Krasniqi. "Qeveria Komunale e Junikut mbetet e përkushtuar që sa më parë ta fillojë konservimin dhe restaurimin e

këtyre objekteve të trashëgimisë kulturore dhe historike qoftë nga buxheti komunal, nga përkrahja e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit apo nga donatorë të ndryshëm. Kullat e Junikut si simbol i qëndresës e bashkimit ndër shekuj kanë pasur rol kyç në çështjet kombëtare ndaj, si të tilla, me krenari do të ruhen dhe trajtohen si vlerë e shtuar e trashëgimisë së larmishme që ka Juniku", është thënë në njoftimin e Komunës së Junikut.




“Titanic”-u, fotot e transatlantikut që shpëtoi të mbijetuarit

Anija arriti në vendin e katastrofës një orë e gjysmë pas fundosjes, më 4 prill 1912, shpëtuan 705 të mbijetuar dhe u nisën për në Nju York, ku mbërriti më 18 prill

Në orën 23:40 të së dielës së 14 prillit 1912, Titaniku i famshëm goditi dhunshëm një aisberg, duke nisur kështu shkatërrimin e anijes më të famshme të 1900-s. Mes pasagjerëve të zënë nga paniku dhe nxitimit për të shpëtuar jetën, u dërgua një mesazh telegrafik në Cape Race, i cili u vu në kontakt me një tjetër transatlantik që lundronte në Veriun e Atlantikut dhe quhej Carpathia. Nisi menjëherë operacioni i shpëtimit: anija mbërriti në vendin e katastrofës, pasi bëri një lundrim të rrezikshëm përgjatë akullnajave, në orën 4 të 15 prillit, një orë e gjysmë pas fundosjes së Titanikut.



Përgjatë orëve në vazhdim, ekipazhi arriti të marrë në bord 705 të mbijetuarit dhe u nis për në Nju York, ku mbërriti në 18 prill. Natën e incidentit, Carpathia lundronte nga Nju York në Fiume. Sapo mori sinjalin e shpëtimit, telegrafisti i Carpathias, Harold Cottam zgjoi kapitenin Arthur Rostron, i cili menjëherë ra në gjurmë të Titanikut dhe u nis me shpejtësinë maksimale (31 km/h). Lundrimi kaloi përgjatë një vendi shumë të rrezikshëm



mbushur me akuj dhe aisbergë, por fatmirësisht atë natë nuk ndodhën dy tragjedi detare. Për ndihmën e dhënë Titanikut, ekipazhi i Carpathias mori

medalie nga vetë të mbijetuarit. Anëtarët e ekipazhit u nderuan me medalie bronxi, zyrtarët me medalie argjenti dhe

komandanti Rostron mori medalien e artë dhe një kupë argjenti, dhënë nga Margaret Broën, një nga të mbijetuarat. Në vazhdim, historia e transatlantikut ishte më pak “heroike”, por gjithaq aventuriere. Gjatë Luftës së Parë Botërore, Carpathia u përdor për të transferuar trupat amerikane në Europë. Më 17 korrik të 1918 u shpëtua nga fundosja në bregun lindor të Irlandës nga nëndetësja gjermane U-55. Ironi e fatit: kësaj here ishte Carpathia që fundosej; pesë anëtarë të ekipazhit vdiqën, ndërkohë që 218 personat e tjerë në bord u shpëtuan të nesërmen nga anija Snowdrop. Rigjetja e Carpathias u bë më 9 shtator të 1999, në fund të oqeanit Atlantik, rreth 298 kilometra në anën më perëndimore të Anglisë. (gazeta-Shqip.com)



Jetëshkrimi i Princes publikohet brenda këtij viti



Jetëshkrimi i Prince Rogers Nelson që filloi të shkruhej kur ai ishte gjallë, do të dalë në fund të vitit 2018. Prince kishte shkruar 50 faqe të jetëshkrimit të

tij para se të vdiste në vitin 2016. Sipas revistës "Variety", këngëtari kishte punuar në biografinë e tij së bashku me autorin Dan Piepenbring.

Abby Lee i nënshtrohet një operacioni urgjent



Abby Lee Miller ka pasur një operacion emergjent, ka raportuar revista "E! News". Hooman Melamed, kirurg i ortopedisë, ka treguar për revistën se Abby Lee kishte një operacion urgjent në

shpinë për shkak të një infeksioni. 51-vjeçarja iu nënshtroa ndërhyrjes për të hequr një masë afër shtyllës kurrizore. Ai ka shpjeguar se nëse masa nuk do të ishte hequr, ajo mund të vdiste ose të paralizohet.



Sofia Richie, në pazar ushqimi

Ajo mund të jetë vajza e legjendës së muzikës Lionel Richie, por modeluesja Sofia nuk ka problem aspak të

kujdeset për shtëpinë e saj. Sofia është parë duke e shtyrë karrocën me ushqim dhe dukej shumë mirë e kombinuar edhe në veshje.

Familja Beckham bashkohet për ditëlindjen e Victorias



Victoria Beckham ka festuar ditëlindjen e 44-të të saj në shoqërinë e bashkëshortit David dhe katër fëmijëve. Ish-anëtarja e grupit Spice Girls ka postuar në rrjetin social "Instagram" një

fotografi me djemtë Brooklyn, 19 vjeç, Romeo, 15 vjeç, Cruz, 13 vjeç dhe vajzën e saj të vetme Harper, 6 vjeç. Më pas ka publikuar edhe një fotografi me ish-futbollistin e famshëm David Beckham.

	Autor: GAZMEND MORINA	PARVAZ, PRAG I DRITARES	BASKETBOLLISTI YNË MALIQI (shq.)	VEND ME VATHË E ME KASOLLE PËR BAGËTITË	↓	FAZA, ETAPA ISH BASKETBOLLISTI SHEKIL	RADIUM	ZANORE	EPOKA E RE	SHTATORE, TRUPORE (shq.)	QYTET I YNI NË MAL TË ZI (shq.)	↓	GJAKATAR MARC ANTHONY	
	FUTBOLLISTI ARGJENTINAS NË FOTO JAVIER (PSG)								SUPER MODELJA KANADEZE JESSICA PIANISTJA LULE					
	QYTET I VJETËR NË KOSOVË								E FRIKËSOVA REGJISORI ... QOSJA					
	KRYEQYTETI I ARABISË SAUDITE							DËSHMORI KODRA (shq.) LIDHJA E ZHIVËS ME NJË METAL TJETËR					ZARZAVATE	
	BANORET E KRYEQYTETIT TE FILIPINEVE											DY BASHKËTINGËLLORE TOTENHAM		
	KYÇ				POETJA BEQIRAJ	INSTITUCION	LËNG QË NXIRRET NGA KULLIMI I NAFTËS NOTË MUZIKORE							EMPOLI LLOJ PESHKU (shq.)
NDËRTESE E POSACME KU SHFAQEN FILMA								ISMET JASHARI AKTORI YNË ... ISLAMI				KADRI ROSHI DY BASHKËTINGËLLORE		
EPOKA E RE	HEROI I YNI NGA PODUJEVA H.... T... (UÇK)	SHTET NË AFRIKE	KLUB FUTBOLLI NË SUEDI	ZANORE	EPOKA E RE	BUJK	KËNGËTARJA MIMANI ILUZIONISTI SHQIPTAR MURA			PUBLICISTI SHQIPTAR NURELLARI I ARRATISUR				
GRAHMË E VDEKJES; AGONI GYPI I ARMËS								QË KA NGJYRËN E HIRIT, I HIRTË PROFIT			ZOTËROJ DIÇKA VARIOLE			
→				NDËRRIM I MALLIT ZANORE			ISH FUTBOLLISTI VATA KRYEQYTETI I MAROKUT (pashq.)					FIJE E HOLLË E PAMBUKU ÇMENDJE		
KAMBANË FARE E VOGËL				ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË SHTET NË AZI					NGJITËS I XHAMAVE (shq.) PARVAZI I DRITARES				NXITËSI I NJË VEPRIMTARIE	
JEVG				KRIMB I DRURIT PIJE ALKOOLIKE			SULMUAR KLUB FUTBOLLI NË SPANJË						BASHKËT. MIMOZA AHMETI	
KAMPIONI, ASI						SKILLAVI KËNGËTARJA LIBOHOVA			MOR, HEJ (pashq.) INSTITUTE ADVANCED MOTORISTS		MA JEP AGIM SOPI			
DESPOTI						FUTBOLLISTI FRANCEZ NASRI VIGANI					RROGË VJETORE E PAPËS MUJET LUNDRIMI (sh.shq.)			
SHKRONJA TË NJËJTA			LETRAT MUJAJ I VITIT (shq.)					VENDËSI, RRËNJËSI PUNIMI I ARËS					ZANORE BASKETBOLLISTI KURAJA	
BASHKËT.		NJË E RESHUR KËNGËTARJA FLAKA		FEMËR E ZGJEDHUR LOCAL AREA NETWORK			"ASHTU QOFTË" AI QË E KISHTE DOBËSI THEMBRËN				AKTORI GIBSON PËRMBLEDHJE LIGJESH E NORMASH TË PASHKRUARA			
VEPËR E KRYER, PUNË				GDHENDUR LLOJ VEPRE MUZIKORE					"... ZAK" QYTET I LASHTË NË ILIRI			DRITON ISAI		
SECILA NGA TRAJTAT E NDRYSHME QË MERR EMRI QË KA TË BËJË ME KËNGËN; ZANOR						KRYEQYTETI I NJË SHTETI EVRO-AZIATIK							INDIA, ZAMBIA AKTORI PRAPASHTICA	
EMËR YNI MASHKULLI SKLLAV I LIRUAR A FSHATAR I LIRË						VEPRIMTARI HASANI (shq.) "DETROIT"				E FILLOVA				
→				KAM DIJENI PËR DIÇKA GOTË PREJ BAKRI			AKTORJA ANGLEZE HURLEY HISTORIANI ROMAK LUKRECI			PJESË E MISHTË E TRUPIT BESNIK (perkdh.)			BASHKËT. DREJTIM	
DISIPLINË SPORTIVE						PAJISJE PËR DREJTIMIN E VETURËS DEM, TER					FUTBOLLISTI KROAT KRAËÇAR DY BASHKËTINGËLLORE			
KËNGËTARJA TAKE						KLINT ISTVUD BASHKËT.			REGJISORJA SHQIPTARE GJONI ZANORE			RRALLË (lat.) ARMENIA		
BRUS ..			ELEMENT KIMIK (shq.)						VEZË PESHKU			PLUHUR I LEHTË QË MBETET PASI DIGJET KREJT DIÇKA		

E jashtëzakonshme

Më shumë se 50 pata të ngordhura ranë nga qielli në Amerikë

Më shumë se 50 pata u gjetën të ngordhura në një parking makinash në Idaho të Amerikës, pasi u goditën nga rrufeja teksa fluturonin në tufë. Të 51 zogjtë po migronin në veri kur u



zunë nga një stuhi në Idaho. Edhe pse patat ishin goditur me copa breshëri aq të mëdha sa topa të golfit, zyrtarët e natyrës besojnë se ato kanë ngordhur si pasojë e vetëtimave.

FOTO E DITES



Mbahet gara e artë "Amstel" me biçikleta në Beek të Holandës. /AFP/

E rrallë

Peshkatori kap kallamarin gjigant, shokohen fshatarët

Një peshkatar i paidentifikuar arriti të shkëpusë një kallamar 2.4 metra të gjatë dhe ua paraqiti atë fshatarëve të habitur, të cilët dyshojnë se mund të ketë më shumë të tillë.



Krijesa gjigante u tërhoq nga bregu në rajonin e largët të ishullit të Tawi-tawi në Filipine.

BARSOLETA E DITËS



Në cilin muaj gratë flasin më pak?
Në shkurt.
Pse?
Sepse i ka vetëm 28 ditë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

"BLACK PANTHER"
3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler




Në ora 17:00

"PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

"PACIFIC RIM UPRISING" (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

"RED SPARROW" (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenarts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Ditët e fundit keni hasur në pengesa që nuk ju kanë lejuar të shihni qartë sa i përket gjendjes suaj të rënduar shpirtërore.



DEMI

Një ditë e tërë në shoqërinë e vetes tuaj sot mund t'ju bëjë veçse mirë. Ju shijon të ecurit në rrugë ose leximin e një libri të mirë.



BINJAKËT

Edhe pse nuk keni gjithçka nën kontroll, kjo nuk do të thotë se nuk menaxhoni dot punën tuaj. Jeni mjaft korrekt dhe autoritar kur bëhet fjalë për profesionalizëm.



GAFORRJA

Nuk mund të lejoni që personat tuaj të afërt të jenë neglizhentë me një çështje të caktuar. Falë ndërhyrjes suaj, gjërat do të rregullohen.



LUANI

Keni shumë gjëra që kanë lidhje me administratën sot për të mbyllur dhe do t'ju duhet ta nisni ditën më herët se zakonisht.



VIRJËRËSHA

Nëse doni të vini nën presion personat afër jush ose bashkëpunëtorët, sot do t'ia arrini qëllimit. Nuk është e thënë se kjo sjellje është e mirë.



PESHORJA

Njerëzit pranë jush e kanë harruar sa person i bukur jeni në shoqëri sepse ju jeni shmangur prej kohësh kontaktit me të tjerët.



AKREPI

Kushtet komode që keni pasur i keni rifituar kohët e fundit dhe kjo gjë ju pëlqen të zgjasë sa më shumë. Do të kërkonit kontakte të reja.



SHIGJETARI

Keni rifituar terrenin e humbur në një çështje personale. Kjo gjë ju ka bërë të bindeni që mjafton pak këmbëngulje dhe mund t'ia dilni.



BRICJAPI

Jeni pak të ndrojtur në kontaktin e parë me të panjohurit. Më pas bëheni shumë shpejt protagonistët e situatave.



UJORI

Nëse nuk doni që dikush t'ju vë me shpatulla për muri dhe t'ju kërkojë llogari, patjetër duhet të përfundoni atë që keni nisur deri në mesditë.



PESHQIT

Mbi disa argumente që nuk jeni në dijeni nuk keni pse debatoni. Do të tregonit që jeni të painformuar mirë lidhur me tema të caktuara.

EURO GLASS
 eg
 SAINT-GOBAIN
 SEKURIT PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
 "BUJQËSIA"
 TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

VALENCIA - GETAFE

1

BENEVENTO - ATALANTA

2

TORINO - AC MILAN

1

Trajneri nga Kosova ka synime të mëdha me Atsv Erlangen

Ish-ylli i futbollit në Kosovë, Shqipran Skeraj, po tregohet i suksesshëm në detyrën e trajnerit në futbollin gjerman. "Jam trajner i skuadrës së Atsv Erlangen që garon në Ligën e Gjashtë në Gjermani, por ambiciet tona janë që të inkuadrohemi në Ligën e Pestë. Si futbollist pothuajse e kam përfunduar karrierën. Ekziston mundësia të luaj sërish, por tash për tash jam i fokusuar në punën e trajnerit, për faktin se ambiciet e mia janë të mëdha në këtë zanat", ka thënë Skeraj për "Epokën e re"



fitojmë", ka shtuar Skeraj, i cili jeton në qytetin e Nurnbergut dhe është i martuar dhe ka dy djem. Në fund Skeraj ka treguar se është mjaft mirë i informuar për futbollin e Kosovës dhe se, sipas tij, Superliga ka vetëm ngritje në cilësi. "Po e përcjelli vazhdimisht futbollin e Kosovës, pasi kam dëshirë të shoh se si përparon çdo ditë e më shumë. Talentet nuk kanë munguar asnjëherë, vetëm kushtet nevojitet të përmirësohen. Prishtinën, që lufton çdo vit për trofe dhe Drita, që është në formë të mirë, i shoh favorite për titull, por e mira e këtij kampionati është se nuk ka diferencë të madhe pikësh në mes të skuadrave", ka deklaruar ai.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 PRILL - Shqipran Skeraj është një nga lojtarët më të mirë në futbollin e pasluftës. Ai në vitin 2009, pas një përvojë të madhe me skuadrën e Prishtinës, vendosi ta bëjë hapin e madh në karrierë, duke u transferua te skuadra e njohur gjermane Greuther Furth. Zhvillimin e mëtejshëm të Skerajt e penguan shumë në zhvillimin e karrierës lojtarin

me prejardhje nga Prizreni. Tash mbrojtësi i krahut në Përfaqësuesen e Kosovës e ka filluar zejen e trajnerit në Gjermani, përkatësisht me skuadrën e Atsv Erlangen në Ligën e Gjashtë. "Jam trajner i skuadrës së Atsv Erlangen që garon në Ligën e Gjashtë në Gjermani, por ambiciet tona janë që të inkuadrohemi në Ligën e Pestë. Si futbollist pothuajse e kam përfunduar karrierën. Ekziston mundësia të luaj sërish, por tash për tash

jam i fokusuar në punën e trajnerit, për faktin se ambiciet e mia janë të mëdha në këtë zanat", ka thënë Skeraj për "Epokën e re". Skuadra e drejtuar nga trajneri i Kosovës aktualisht pozicionohet e dyta në Ligën e Gjashtë,

por Skeraj beson se suksesi nuk do të mungojë. "Besoj shumë se do t'ia arrijmë qëllimit që të inkuadrohem në një ligë më lart. Ekipi i parë që është në tabelë ka tri pikë më shumë, por e kemi përballjen e drejtë-përdrejtë dhe besojmë se do të

Shqipran Skeraj fillimisht synon të fitojë përvojë sa më të madhe si trajner në futbollin gjerman, duke arritur të drejtë-jë edhe klube të njohur e, më pas, nëse i jepet rasti, të punojë edhe në Përfaqësuesen e Kosovës në futboll.

Vëllaznimi - Prishtina, finalja e Kupës në futboll



PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Finalja e Kupës do të zhvillohet në mes të dy rivalëve të vjetër, Vëllaznimit dhe Prishtinës. Skuadra kryeqytetase, pas vazhdimëve, e siguroi kualifikimin në finale, pasi në kohën e rregullt vushtriasit fituan 1-0, sikurse që kishte fituar Prishtina në ndeshjen e parë. Golin e parë në këtë ndeshje e shënoi Daut Maxhuni në minutën e 48. Në vazhdimë "bardhekaltrit" ishin

më të vëmendshëm, duke shënuar golin e fitores në minutën e 98 nëpërmjet Basit Khalidit. Vushtrria u mundua të rikthehet në lojë por, pa sukses. Ndërsa Vëllaznimi nga Gjakova e siguroi finalen duke iu falënderuar golit si mysafir në ndeshjen e parë. Ndeshja e parë e zhvilluar në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj kishte përfunduar 1-1, kurse në ndeshjen kthyesë që u zhvillua në Gjakovë rezultati final ishte 0-0.

Altin Zogaj debuton më 5 maj në boksion profesionist

PRISHTINË, 18 PRILL - Boksieri me prejardhje nga Komorani i Drenasit të Kosovës, Altin Zogaj, i cili jeton dhe vepron në Shtutgart të Gjermanisë, ka vendosur ta bëjë hapin madh duke kaluar në boksion profesionist, kurse debutimi i tij pritet të bëhet më 5 maj në qytetin e Nurnbergut. Zogaj

ende nuk i është caktuar kundërshtari për meçin më të rëndësishëm në karrierën e gjertanishme. Ai ekskluzivisht për agjencinë për sporte luftarake "ArenaRing" ka thënë se është shumë i gëzuar me një ngritje të karrierës së tij. "Me boks kam filluar të merrem nga viti 2015, kurse për një kohë të

shkurtër arrita të bëhem dy herë kampion i Republikës së Baden-Wurttemberg në 81 kg, ndërkohë që arrija shumë suksese edhe në turne ndërkom-bëtarë. Duke parë se po formohem si boksier, vendosa të kaloj në boksion profesionist, ku debutimin do ta kem më 5 maj në Nurnberg të Gjermanisë,

por kundërshtari ende nuk është caktuar dhe pres javën tjetër që ta di edhe emrin e tij", ka deklaruar Zogaj, i cili stërvit në Shtutgart me familjarin e tij Festim Kryeziu alias Timo Schwarzkopf. "Jam duke u përgatitur maksimalisht me Festimin dhe trajnerët e mi, pasi synoj debutim me sukses.



Planet e mia janë që në të ardhmen të ndeshem edhe për titull", ka deklaruar boksieri nga Kosova.

Kampioni Ilir Latifi, së shpejti në Tiranë

TIRANË, 18 PRILL - Sportisti me famë botërore, Ilir Latifi, do të jetë së shpejti në Tiranë për një turne promovues të MMA-s. Kampioni i peshave të rënda në Suedi dhe profesionist që prej vitit 2008 vjen për herë të parë në Shqipëri. Sporti i MMA ka filluar të përhapet me shpejtësi në të gjithë botën dhe nëse flitet për

disiplina luftarake siç është MMA, patjetër që mes tyre ka edhe emra shqiptarësh. E një prej më të njohurve është Ilir Latifi, i lindur në Malmö të Suedisë, por me orgjinë nga Kosova. Kampioni më famë botërore do të jetë në Tiranë nga 27 prilli deri më 2 maj, për të zhvilluar një vizitë zyrtare, për ta

promovuar më tej sportin e MMA. Ilir Latifi vjen për herë të parë në Shqipëri dhe gjatë vizitës së tij disaditore pritet të takohet me kreun e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ndërsa do të zhvillojë edhe disa stërvitje demonstrative me sportistë dhe të rinj të pasionuar të këtij sporti. Latifi është një

kampion i njohur i peshave të rënda në Suedi dhe si profesionist i këtij sporti që nga viti 2008, ai ka marrë pjesë në turne të rëndësishëm si Shark Fights, Rumble of The Kings, dhe GLORY. Që prej muajit shkurt të këtij viti Ilir Latifi mban vendin e katërt në renditjen e peshave gjysmë të rënda në divizionin UFC.



Salihu: Letra është ekzagjeruar, presim sugjerime nga UEFA

PRISHTINË, 18 PRILL - Sekretari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Eroll Salihu, ka folur rreth letrës së pranuar nga UEFA pas inspeksionit të stadiumit të Prishtinës nga inspektorët e saj. Salihu për "KosovaPress" ka deklaruar se punimet në stadiumin e Prishtinës janë dukë shkuar siç e duhur, kurse përkrahja e MKRS-së nuk po mungon. "Këto takime, këto korrespondenca janë të vazhdueshme me organet e UEFA-s, por edhe të FIFA-s. Zotëri Pjetër Cadrera është një ndër përgjegjësit kryesor për infrastrukturën sportive, dhe ai ka dërguar disa inspektorë për ta parë ecurinë e punimeve, sepse duhet të kuptojmë se edhe ata janë të shqetësuar, sepse është edhe një dështim për FIFA-n dhe UEFA-n për të pranuar një anëtar të ri i cili nuk ka një fushë. Kështu që, duhet të kuptojmë se qëllimet janë plotësisht të mira, ata na kanë tërhequr vëmendjen, por do të na dërgojnë një listë me përmirësime të cilat duhen bërë që stadiumi të jetë funksional



me kohë. Ne kemi menduar fillimisht se, ndoshta, në fillim të qershorit do të përipiqemi të zhvillojmë një ndeshje testuese", ka thënë Salihu.

Për çështjet të cilat duhet të zgjidhen sekretari i FFK-së bëri me dije se ka shumë, por beson se deri në qershor gjithçka do të përfundojë. "Aty ka shumë kriteret, por janë çështje të cilat duhen zgjidhur, për shembull sistemi i kamerave, CCTV duhet rezolucion i jashtëzakon-

shëm, pasi televizioni është burimi më i madh i të ardhurave, kështu që kushtet për ta duhet të jenë më të përkryera, edhe për gazetarët për media. Por, janë edhe çështjet e tjera, si ndriçimi nuk është ende askund dhe çështje të tjera", ka shtuar Salihu.

Kosova, sipas Salihut, do t'i zhvillojë ndeshjet nga shtatori në stadiumin e qytetit në Prishtinë, duke hedhur poshtë polemikat se Kosova sërish duhet të udhëtojë në Shkodër.

Toronto, Bostoni dhe New Orleansi dominojnë në 'play-off'

TORONTO, 18 PRILL - Toronto çon në 2-0 avantazhin me ndeshje ndaj Washingtonit, në takimet çerekfinale të "play-off"-it të NBA-së, në Konferencën e Lindjes. Gjashtë lojtarë të ekipit kanadez realizuan mbi 10 pikë, me DeRozan që ishte shënuesi më i mirë në fushë, autor i 37 pikëve, lider në fushë. John Wall për Washingtonin realizoi 29 pikë, por që nuk mjaftuan për ta evituar humbjen. Fiton edhe Bostoni që, ashtu si Toronto, udhëheq 2-0 serinë e çerekfinaleve ndaj Milwaukee. Skuadra e Celticsit mposhti 120-106 rivalët e Bucksit, ndeshje e dominuar nga basketbollistët e Bostonit. Brown realizoi 30 pikë e Rozieri 23, ndërkohë që 41 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit. Për Milwaukee u dallua Antetokoumpo, autor i 30 pikëve, por që mbetën për statistikë. Fiton edhe skuadra e New Orleansit, që mposhti 111-102 Portlandin, duke udhëhequr 2-0 serinë e çerekfinaleve. Kjo është fitorja e dytë radhazi jashtë fushës e ekipit të New Orleansit, që po befason në këtë fazë të "play-off"-it.



Holiday me 33 pikë ishte lider në fushë për miqtë, ndërsa Davisi realizoi 22 pikë e 13 rebaunde. Për

Portlandin u dallua McCollum me 22 pikë, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen.

KONFERENCA E LINDJES

1-8, Toronto - Washington	130-119 (2-0 me ndeshje)
2-7, Boston - Milwaukee	120-106 (2-0 me ndeshje)
3-6, Philadelphia - Miami	(barazim 1-1 me ndeshje)
4-5, Cleveland - Indiana	(0-1 me ndeshje)

KONFERENCA E PERËNDIMIT

1-8, Houston - Minnesota	(1-0 me ndeshje)
2-7, Golden State - San Antonio	(2-0 me ndeshje)
3-6, Portland - New Orleans	102-111 (0-2 me ndeshje)
4-5, Oklahoma - Utah Jazz	(1-0 me ndeshje)

SHKURT

Ibra: Një botëror pa mua s'do të ishte botëror

Tashmë s'ka më dyshime, në Rusi do të jetë edhe Zlatan Ibrahimoviç. Ka qenë vetë suedezi ai që ka konfirmuar lajmin. "Po, do të jem në Rusi. Është e vetmja gjë që mund të them", ka deklaruar Ibra, tanimë pjesë e Los Angeles Galaxy, duke vënë në dukje se është gati të rikthehet në kombëtare, pas lamtumirës të bërë me stil në "Euro 2016": "Një botëror pa mua s'do të ishte botëror". Ditë më parë Ibrahimoviç ka vënë në presion trajnerin Andersson, duke theksuar se do të vendoste vetë ai nëse do të merrte pjesë apo jo në Botërorin që do të luhet në Rusi. Suedezi ka treguar se është në një superformë sapo është bërë pjesë e Los Angeles dhe dëshiron të marrë pjesë me çdo kusht në Botërorin e fundit të karrierës së tij. "Nuk jam suedezi tipik, por e ka vendosur Suedinë mbi një hartë...", ka qenë një prej batutave të bëra nga sulmuesi.

Kaka: Isha i lumtur kur u largova nga Real

Leite Kaka ka thënë se ndihet i penduar për largimin e parë nga AC Milan. Ish-mesfushori brazilian e konsideron të gabuar transferimin në Real Madrid ku nuk e kishte besimin e menaxherit Jose Mourinho. "Isha shumë i lumtur pas largimit nga Real Madridi dhe rikthimit në Milan. Mourinho nuk më besonte edhe pse gjithmonë ka thënë se jam një prej futbollistëve më profesionistë me të cilin ka punuar", ka thënë Kaka.

Klose, trajner i të rinjve në Bayern

Miroslav Klose është gati të rikthehet në botën e futbollit. Një nga sulmuesit më të shquar të futbollit gjerman ka vendosur të nisë një karrierë të re, atë të trajnerit, pasi si lojtar e mbylli në vitin 2016 me fanellën e Lazios. 39-vjeçari do të jetë pjesë e ndryshimeve të Bayern Munchenit për sezonin e ardhshëm ku, pas Kovaçit, në stol si trajner ai do ta marrë drejtimin e ekipit të të rinjve. Klose ka arritur akordin me drejtuesit "bavarezë" dhe tashmë vetëm pret fundin e këtij sezoni për ta nisur aventurën e re si trajner.

Zidane mohon problemet me Balen

Zinedine Zidane ka insistuar se nuk ka asnjë problem me Gareth Balen, edhe pse e zëvendësoi pas pjesës së parë në ndeshjen e kthimit çerekfinale të Real Madridit kundër Juventusit në Ligën e Kampionëve. "Ky është futboli. Nuk i njoh asnjërin prej tyre të trishtuar, janë duke u stërvitur mirë. Kam folur me Balen dhe Benzeman. Atyre u pëlqen të shënojnë më shumë gola. Të gjithë po punojnë shumë mirë", ka thënë Zidane.

Dembele mund të largohet nga Tottenhami

Mesfushori Mousa Dembele pritet që gjatë verës të largohet nga Tottenham Hotspuri. Lajmin e ka bërë me dije të mërkurën "Daily Mirror". 30-vjeçari ka edhe një sezon të mbetur në kontratën e tij me "Spursin", por transferimi i tij në kampionatin kinez është shumë i mundur. Largimi i tij mund të mos ndodhë vetëm nëse trajneri Mauricio Pochettino nuk largohet nga Tottenhami, pasi trajneri argjentinas është një tifoz i madh i Dembeles.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administratës Publike
Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

KONKURS

Në bazë të Nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Nenit 8 të Rregullores Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Administratës Publike rishpall konkurs për këtë vend pune:

Titulli i vendit të punës:

Drejtor i Përgjithshëm në Institutin e Mjekësisë Ligjore - Ministria e Drejtësisë (1).

Paga mujore: 1.171.17 € bruto.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Siguron këshilla të politikave për Ministrin; siguron që vendimet e politikave dhe masat tjera të Institutit të zbatohen në mënyrë efikase dhe efektive; siguron që masat zbatuese të Institutit të monitorohen rregullisht dhe që të merren masa korrigjuese në rast të pengesave; menaxhon nëpunësit civil dhe punonjësit tjerë të Institutit; menaxhon financat dhe burimet e tjera të Institutit; menaxhon rrjedhën e informacionit në Institut dhe koordinon raportet e Institutit me organet e tjera vartëse administrative etj.
- Përshkrimin e plotë të detyrave dhe përgjegjësi të punës për këtë pozitë mund të gjeni në linkun <http://map.rks-gov.net/getattachment/2c956b17-b2ba-459f-8131-c240e190cfe3f.aspx>

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar; janë në posedim të të drejtave civile dhe politike; kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative, që sipas ligjit kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrimit:

- Konkurrimi për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm është i hapur dhe kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë nëpunësit civilë në pozita të larta drejtuese, pozita drejtuese ose në pozita të barasvlershme në institucionet e administratës publike apo në kompanitë publike ose private.

Shkollimi i kërkuar:

- Diplomë universitare (minimum 4 vjeçare pas shkollës së mesme) apo të avancuar, e përfunduar në fushat që ndërlidhen me punën e Institutit përkatës.

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Duhet të kenë shkathtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit; aftësi të larta organizative dhe drejtuese; aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negociimit; aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve; standarde të larta të integritetit; ndershmërisë dhe drejtësisë; njohuri bazike në programet e kompjuterit.
- Së paku 8 vjet përvojë pune profesionale përfshirë së paku 5 vjet në nivelin drejtues pas diplomimit në universitet.
- Njohja e gjuhëve të huaja ka përparësi në rast të vlerësimit të barabartë të kandidatëve.
- Njoftohen aplikantët se pjesë e vlerësimit të përzgjedhjes do të jenë kriteret e hollësishme të paraqitura në përshkrimin e vendit të punës.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

- Përzgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit:

- Mandati për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm është 3 vjet.

Data e mbylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendrike nga dita e publikimit.

Paraqitja e kërkesave:

- Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Ministrinë e Administratës Publike, Zyra e Personelit, dhoma nr. 320, kati III, ndërtesa e Pallatit të Shtypit, Prishtinë, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: <http://map.rks-gov.net>. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës; dëshminë për përvojën e punës; dëshminë se nuk është në hetime apo i dënuar për vepër penale (e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së këtij konkursi) dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës.
- Aplikuesit duhet të paraqesin: 1) një CV; dhe 2) një letër motivim me shpjegime të qarta dhe shembuj nga përvoja profesionale që tregojnë se si përvoja dhe aftësitë e tyre përputhen me kërkesat e vendit të punës.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë."

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3, të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.
- Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin për verifikim dokumentet origjinale.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni znj. Sala Shala në tel: 038-20030620, prej orës 8:00 - 16:00.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administratës Publike
Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

KONKURS

Na osnovu člana 15 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova i člana 8 Uredbe br. 06/2010 o Proceduri imenovanja u Visokim Upravnim Pozicijama u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Javne Uprave objavljuje konkurs za sledeće radno mesto:

Naziv radnog mesta:

- Generalni Direktor Instituta za Sudsku Medicinu / Ministarstvo pravde (1).

Mesečna Plata: 1.171.17 € bruto.

Zadaci i odgovornosti :

- Obezbeđuje političke savete Ministru; obezbeđuje da političke odluke i druge mere Instituta sprovedu efikasno i efektivno; obezbeđuje da mere sprovedenja Instituta a se redovno nadgledaju i da se preduzimaju neophodne mere za prevazilažavanje prepreka; upravlja civilnom službom i ostalim zaposlenima Instituta; upravlja financije i ostale izvore Instituta; upravlja tokom informacija u Institutu i koordinira izveštaje Instituta sa ostalim nadležnim organima administracije itd.
- Kopmpletan opis radnih zadataka i odgovornosti za ovu poziciju možete naći na dolo navedenom linku <http://map.rks-gov.net/getattachment/911262db-0474-4480-859c-44d39fc38fa9/>

Uslovi učestvovanja regrutiranja su:

- U Civilnoj službi, imaju pravo da se zapošljavaju svi državljani Republike Kosova koji su odraslog doba i koji imaju punu sposobnost delovanja; koji poseduju civilna i politička prava; koji poseduju neohodno obrazovanje i stručnu spremu za obavljanje ekzekutivnih zadataka, upravljanja ili sprovedenja administrativnih funkcija i da imaju fizičku sposobnost, koje su neophodne prema zakonu za dotičnu poziciju.

Procedura konkursa:

- Konkurs za poziciju Generalni Direktor je otvoren i pravo konkurisanja imaju civilni službenici koji su u visoko upravnim pozicijama, upravnim pozicijama ili pozicija koji su podjednaki u javnim ili privatnim kompanijama.

Zahtevano obrazovanje:

- Diploma univerziteta (minimum 4 godine nakon srednje škole) ili više, poželjna iz oblasti koja su nadovezana sa dotičnim poslovima Agencije.

Sposobnosti, iskustvo i ostala svojstva koja se zahtevaju :

- Potrebno je posedovati sposobnosti za određivanje i postizanje strateških objekta institucije, kao i visoke sposobnosti organizovanja i upravljanja; odlične sposobnosti komuniciranja i sporazuma; dokazane sposobnosti za analiziranje stanja i predlog opcija; standarde visoka integriteta, poštovanja i pravde; osnovno vladanje kompjuterskim programima.
- Najmanje 8 godine radnog iskustva u profesiji, uključujući najmanje 5 godina upravnog nivoa nakon diplomiranja.
- Poznavanje stranih jezika predstavlja prednost prilikom ravnopravnog vrednovanja kandidata.
- Obaveštavaju se aplikanti da će se vrednovanja bazirati na osnovu bližih detalja koji se nalaze u opisu radnog mesta.

Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutiranje:

- Izbor Generalni Direktor se vrši u skladu sa Zakonom br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova i Uredbe br. 06/2010 za Procedure Imenovanja u Visokim Upravnim Pozicijama Civilne Službe Republike Kosova i Uredbe br. 02/2010 za Procedure Rekrutiranja u Civilnoj Službi.

Trajanje mandata :

- Mandat za poziciju Generalni Direktor je 3 godine.

Datum zatvaranja konkursa:

- Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja.

Podnošenje zahteva:

- Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Ministarstvu Javne Uprave, kancelarija Personela, br. 320, III sprat, zgrada bivšeg Doma Štampe, Priština ili preko elektronske adrese kroz: <http://map.rks-gov.net>. U prilogu Aplikacije neophodno je da se dostave kopije dokumentacije o kvalifikaciji, za diplomirane u univerzitetima van zemlje treba da dostave dokaz o nostrificiranju diplome; dokaz radnog iskustva; dokaz da nije pod istragom ili kažnjavanjan za krivično delo (koja ne sme biti starija od datum proglašavanja ovog konkursa), i druge dokumentacije koja se zahtevaju za apliciranje za pomenuto radno mesto.
- Aplikanti treba da dostave: 1) jedan CV- u i 2) jednu pismo motivacije uz jasno objašnjenje i primere profesionalne iskustva koje pokazuju kako iskustvo i sposobnosti poklapaju sa zahtevima radnog mesta.

"Civilna Služba Kosova pruža ravnopravne mogućnosti zapošljavanja za sve držaojlane Kosova i očekuje aplikacije od strane oba pola i članova svih zajednica na Kosovu."

Nevećinske Zajednice i njihovi pripadnici imaju jednako i proporcionalno pravo predstavljanja u organima Civilne Službe centralne i lokalne administracije, kao što je naglašeno članom 11, stav 3, Zakona br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova".

- Zahtevi nakon određenog dana yatvaranja konkursa se neće ne primati. Ne kompletirana dokumentacija se također neće primati.
- U slučaju velikog broja prijema zahteva, kontaktiraće se samo kandidati koji su izabrani za uzi krug. Kandidati koji su izabrani i pozvani na intervju, potrebno je sa sobom da donesu originalne dokumente radi verifikacije.

Za detaljne informacije, možete se obratiti gđi. Sala Shala br. tel: 038-20030620, između 08:00 - 16:00 časova svakog radnog dana.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada - Government
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
 Univerziteteske Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Sektori i Personelit

Nr.Ref. 332/18, datë 16.04.2018.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

V E N D I M
Për përsëritje të Konkursit publik,

- I. Konkursi publik nr. 481, datë 27.03.2018, për pozitën Drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë dhe Drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Vushtrri, vazhdohet edhe për dy javë nga dita e publikimit në njërin nga mjetet e informimit.
- II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pas njoftimit nga Sektori i Personelit nr. 316 datë 13.04.2018, rreth aplikimit të kandidatëve sipas Konkursit publik nr. 481 datë 27.03.2018 për një Drejtor të Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë dhe një Drejtor të Spitalit të Përgjithshëm në Vushtrri, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, kërkon përsëritjen e Konkursit publik edhe për dy javë për shkak që të ju jepet mundësia e konkurimit kandidatëve edhe nga aspekti nacional, gjinor dhe shkencor.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI TË DORËZOHET

- ✓ Zyrës së personelit,
- ✓ Një mediumit informativ.
- ✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada - Government
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
 Univerziteteske Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Sektori i Personelit

Nr.Ref. 332/18, data 16.04.2018.

U skladu sa članom 13 stav 3 Statuta Kosovske bolnice i službe za kliničku bolnicu, Generalni Direktor SHSKUK-a izdao je sledeće:

O D L U K A
Za ponavljanje djelimično javnog konkursa

- I. Javni konkurs br. 481, od 27.03.2018. Godine za poziciju Direktor Opšte Bolnice u Mitrovici dhe Direktor Opšte Bolnice u Vučitrnu, produžava se dve nedelje od dana objavljivanja u jednom od sredstava informisanja.
- III. Sektor kadrova je obavezan da izverši ovu Odluku;
- II. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

O b r a z l o ž e n j e

Nakon obavještenja iz Sektora kadrova br. 316 od 13.04.2018. Godine, u pogledu aplikacije kandidata prema javnom konkursu br. 481 od 27.03.2018. godine za Direktora Opšte Bolnice u Mitrovici i Direktora Opšte Bolnice u Vučitrnu, Generalnog Direktora UBKSK-a, zahteva ponavljanje javnog nadmetanja za dve nedelje zbog mogućnosti konkursanja kandidati iz nacionalnog, rodnog i naučnog aspekta.

Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI

- * Kancelarija za kadrove,
- * Informacioni medij.
- * Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetit Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit

Nr. Ref. 336/18, datë 17.04.2018.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës, nenit 13 pika 1 e Statutit të QKUK-së, nenit 4 pika 6, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Rekomandimit të Kryesuesit të Komisionit përzgjedhës të datës 06.04.2018, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

V E N D I M
Për Anulim të Konkursit publik,

- I. Konkursi publik nr. 403, datë 13.03.2018 për pozitën **Zyrtar i Prokurimit** (1 pozitë në QKUK), **anulohet në tërësi.**
- II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Përzgjedhës sipas Vendimit nr. 403/2 datë 14.03.2018, i shqyrtoi të gjitha dosjet e kandidatëve sipas Konkursit Publik për një Zyrtar të Prokurimit në Sektorin e Prokurimit të QKUK-së / SHSKUK-së, po ashtu edhe baza ligjore e publikimit për konkursin publik nuk është zbatuar në tërësi, meqë nuk është marrë për bazë neni 4 paragrafi 6 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, duke pasur për bazë se në QKUK, ka punëtorë të cilët janë të përgatitur dhe të certifikuar për Zyrtar të Prokurimit.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe rekomandimit në fjalë, lejon anulimin e Konkursit publik.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'Ë DORËZOHET
✓ Zyrës së personelit,
✓ Një mediumit informativ.
✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së
Dr. Basri Sejdiu

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetit Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit

Nr. Ref. 336/18, data 17.04.2018.

U skladu sa članom 13 stav 3 Statuta Kosovske bolnice i službe za kliničku bolnicu, članom 13 tačka 1 Statuta UKCK, članom 6 tačka 5.1, Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkursa u javnom sektoru, i Preporuka predsednik Komisije za izbor na dan 06.03.2018. godine, Generalni Direktor UBKSK-a izdaje sledeće:

O D L U K A
Za poništenje (anulira) javnog konkursa

- I. Javni konkurs br. 403, od 13.03.2018. Godine za poziciju Službeniak za Nabavku, (1 pozicija u UBKSK) je u potpunosti poništen.
- III. Sektor kadrova je obavezan da izverši ovu Odluku;
- II. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

O b r a z l o ž e n j e

Komisija za izbor po odluci br. 403/2 od 14.03.2018. Godine, pregledala sva dokumentacije kandidata na javnom Konkursu za Službenika za Nabavku u Sektoru Nabavki UKCK / UBKSK, kao i pravni osnov za objavljivanje javnog konkursa nije sproveden u jer nije preduzeta u skladu sa članom 4 stav 6 Administrativnog Uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanju Procedura za Konkursa u javnom sektoru, imajući u vidu da u UKCK postoje zaposleni koji su pripremljeni i sertifikovani za službenika za nabavku.

Stoga, Generalni Direktor UBKSK-a, u skladu sa nadležnostima, i sa važećim zakonom i odgovarajućom preporukom, dozvoljava otkazivanje javnog nadmetanja.

Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI
* Kancelarija za kadrove,
* Informacioni medij.
* Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.
Dr. Basri Sejdiu

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Zeqir Regjaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHF "Dëshmoret e Kabashit " Korishë

► Nehal Mafizallari shpall te pavlefshme diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren

► Afrim Selimaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Ramadan Cakaj shpall te pavlefshme dëftesat SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren

► Jetmir Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHF "Leke Dukagjini" Prizren.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truallit frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truallit frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshohet me qira banesën tri dhomshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxejje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësorjëm me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkohet kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

URGJENTISHT KËRKOJ BANESË PËR ZYRE ME QIRA

Në qendër të Prishtinës, kërkohet banesë me qira, për zyre. Hapësira 80-100m2.

Kati i -1- deri në katin -III-.
Tel: **044741155**

Lajmërohen bashkëpronarët e ngastrës kadastrale P-70202016-0440 bk-O, se bashkëpronari Arif Gërxhalii ka shprehur dëshirën që t'ashë një pjesë të pronës së vet. Andaj njoftohen bashkëpronarët e kësaj parcele kadastrale që nëse janë të interesuar për blerjen e kësaj parcele-pjesën e pronës të lajmërohen te bashkëpronari Arif Gërxhalii.

LËSHOJ LOKALIN ME QIRA.

Lokali gjendet në rrugën "Isa Kastrioti" në Matiqan të Prishtinës dhe ka një hapësirë prej 400 m2. Lokali është i gatshëm dhe shumë funksional. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-509-077.

Urgjentisht kërkohet një shtëpi me qira në Prishtinë.

Shtëpia duhet të jetë e veçantë, duhet të ketë 5 ose 6 dhoma gjumi.

Çmimi sipas marrëveshjes. Tel 049-472-770

► Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshohet banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshohet banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshohet banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshohet me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshohet banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

